




Republika e Kosovës
 Republika Kosovo – Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
 Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije
 Ministry of Education, Science, Technology and Innovation



MODULI 1

E Drejta për Edukim Edukimi Cilësor

Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore



Fakulteti i Edukimit



INSTITUTI I KUALITETIT DHE ZBURNIMIT ARSIMOR

MODULI 1

E Drejta për Edukim Edukimi Cilësor

Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore

Falënderim

Ky material është zhvilluar dhe publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Qeverisë Gjermane.

Teksti origjinal në gjuhën Shqipe [2017] dhe i rishikuar [2020]

E drejta për përdorim, riprodhim dhe redaktim i është bartur Universitetit të Prishtinës – Fakultetit të Edukimit dhe Institutit për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit [2021]

Përmbajtja e tekstit origjinal është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin zyrtar të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo të Qeverisë Gjermane.

Autorë:

Carmen Matheis, Landesakademie Bad Wildbad, Germany
M.Sc Selim Mehmeti

Rishikuar nga:

Marianne Müller RSD Freiburg, Germany
Dr. Majlinda Zhitija Gjellaj, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Dr. Osman Buleshkaj, ekspert i arsimit

Koordinuar nga:

Lirie Lokaj, GIZ

Dizajni dhe faqosja nga:

Envinion, Prishtinë



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

→ MODULI I PARË' TRAJTON KOMPONENTËT
VIJUES TË STANDARDEVE:

STANDARDI 1:
**Udhëheqja
dhe Motivimi**

- ✓ Procesi i ndryshimit
- ✓ Roli i menaxhmentit të shkollës për edukim cilësor
- ✓ Standardet për shkollat miqësore ndaj fëmijëve
- ✓ Udhëheqja efikase

STANDARDI 2:
**Cilësia e
Mësimdhënies dhe
Mësimnxënies**

- ✓ Çka është shkollë e mirë?
- ✓ Mësimdhënia e cilësisë së lartë
- ✓ Kultura mësimore
- ✓ Gjithëpërfshirja

STANDARDI 5:
**Legjislacioni
dhe Shoqëria**

- ✓ E drejta në arsim?
- ✓ Përkufizimi i edukimit cilësor
- ✓ Standardet për shkollat miqësore ndaj fëmijëve
- ✓ Masat për cilësi
- ✓ Kultura e shkollës
- ✓ Rregullat e shkollës

STANDARDI 6:
Etika Profesionale

- ✓ Roli i menaxhmentit të shkollës për edukim cilësor

Përmbajtja

1. Hyrje	6
1.1. Qëllimi i modulit.....	8
1.2. Performanca e pritur	9
2. E drejta për edukim	10
3. Korniza ndërkombëtare për edukim cilësor	13
3.1. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm/OZHQ	13
3.2. Iniciativa "edukimi për të gjithë"/EPGJ	13
3.3. Edukimi në BE.....	14
3.3.1. Objektivat e BE-së në edukim dhe trajnim (standardet e krahasimit për vitin 2020).....	15
3.4. Plani Strategjik për Arsim në Kosovë 2017-2021	16
4. Edukimi cilësor: përkufizimi dhe faktorët përcaktues.....	18
5. Edukimi Cilësor dhe Zhvillimi Ekonomik	19
6. Nga Edukimi sasior në edukim cilësor	21
7. Masat e sistemit cilësor	24
8. Të kuptuarit e edukimit cilësor	26
8.1. Roli i udhëheqjes së shkollës në edukimin cilësor	33
8.2. Standardet për menaxhim dhe udhëheqje në shkolla.....	34
8.3. Mekanizmi i ri për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë	35
9. Përmbyllja e Modulit	38
Fjalorthi	38
Referencat	40
Shtojcat	42
Shtojca 1: Deklarata e të Drejtave të Njeriut	42
Shtojca 2: Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës.....	44
Shtojca 3: Objektivat Zhvillimore të Qëndrueshme	47
Shtojca 4: Traktati i Lisbonës.....	48
Shtojca 5: Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032.....	50
Shtojca 6: Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021	57
Shtojca 7: Korniza e Kurrikulit të Kosovës	63
Shtojca 8: Standardet për praktikën profesionale për drejtorët e shkollave në Kosovë.....	67
Shtojca 9: Objektivat e Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë	73

Akronimet dhe Shkurtesat

UA	Udhëzimi Administrativ
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
EpGj	Edukimi për të Gjithë
BE	Bashkimi Evropian
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
GIZ CDBE	GIZ Ngritja e Kapaciteteve në Arsimin Fillor
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
SZHM	Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
SSC	Strategjia për Sigurimin e Cilësisë
SZHQ	Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm
KDSh	Këshilli Drejtues i Shkollës
DUDNj	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

1. Hyrje

Ngritja e kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet e Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës. Fakulteti ka ofruar studime të nivelit Master në fushën e udhëheqjes dhe menaxhimit të arsimit që nga viti 2010 dhe në këtë program janë diplomuar numër i konsiderueshëm i udhëheqësve aktual të shkollave dhe institucioneve të tjera edukative.

Përkundër kësaj, nevoja për zhvillim profesional në këtë fushë, vazhdon të jetë nevojë dhe interes i shumë individëve dhe institucioneve në Republikën e Kosovës. Në këtë mënyrë, Fakulteti i Edukimit në kuadër të Institutit për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA), me mbështetjen e GIZ-CDBE, do të ofrojë programin e zhvillimit profesional për ngritjen e kapaciteteve në udhëheqjen arsimore për të gjithë udhëheqësit e interesuar në fushën e arsimit.

Duke qenë se drejtorët luajnë një rol kyq në zhvillimin e cilësisë dhe se roli i tyre ka ndryshuar dhe ka levizur nga një udhëheqje teknike në atë menaxheriale trajnimi do të jetë mbështetës i Qasjes së Zhvillimit të Integruar të Shkollës (ISDA) me qëllim të promovimit të një stili horizontal të menaxhimit, i cili mundëson pjesëmarrjen e të gjithë akterëve të shkollës në vendimmarrje.

Qëllimi i përgjithshëm i programit të trajnimit është të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e menaxhimit të shkollës në mënyrë që të përmirësohet cilësia e arsimit për të gjithë. Për këtë qëllim, aspektet relevante janë identifikuar dhe shtjelluar në bazë të vlerësimit të trajnimeve. Programi përbëhet nga 7 module, secili prej tyre shërben për një qëllim të caktuar dhe përcakton rezultatet e pritura.

Programi i trajnimit bazohet në dokumente ligjore dhe politika arsimore të cialt promovojnë gjithëpërfshirjen duke u nisur nga postulate “Të gjithë kanë të drejtën për edukim” ashtu siç garantohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ)¹, e cila u miratua në vitin 1948. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KDF)², e cila u miratua në vitin 1989 si konkretizim i të Drejtave Universale të Njeriut për Fëmijët, e konkretizon të drejtën për edukim. KDF-ja është afër ratifikimit universal dhe prandaj është një traktat ndërkombëtar i të drejtave të njeriut që e ka pajtimin nga e gjithë bota. Sipas nenit 22³ të Kushtetutës së Kosovës, DUDNJ-ja dhe KDF-ja janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë.

1 Shiko shtojcën: Shtojca 1: Deklarata e të Drejtave të Njeriut

2 Shiko shtojcën: Shtojca 2: Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës

3 Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare si më poshtë janë të garantuara me këtë Kushtetutë, janë të zbatueshme drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës, dhe në rastin e konfliktit, i tejkalojnë dispozitat e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e tij;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial;
- (6) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave;
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijëve;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtitimit ose Ndëshkimit tjetër Misor, Johuman ose Degradues;



Të gjithë nxënësit kanë të drejtë për edukim” – çka do të thotë kjo për Kosovën dhe kontekstin e Kosovës?

Ligji i ri i Arsimit Para-Universitar⁴ deklaron në mënyrë shprehimore në nenin 3.1.: “Asnjë personi nuk guxon t’i mohohet e drejta për arsim”.

Në vitet e fundit, edukimi është parë si faktor kyç i zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve njerëzore, krijimit të paqes dhe sigurisë, formësimit të vlerave universale si dhe përmirësimit të cilësisë së jetës në nivel individual, familjar, shoqëror dhe global. Kosova është e përkushtuar për të përmirësuar situatën aktuale në edukim, duke ofruar mundësi më të mëdha të pjesëmarrjes në edukim për të gjithë fëmijët.

Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar të Kosovës 2016-2020⁵ të zhvilluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Ky dokument strategjik nënvizon qartë nevojën për të rritur cilësinë duke ndërtuar një mekanizëm efektiv për të siguruar cilësi në nivele të ndryshme të nën-sektorit parauniversitar.

Sfida është se si të rritet cilësia dhe gjithëpërfshirja!

PPjesëmarrja sa më e lartë në shkollë si e tillë nuk është një garanci për të nxënësit të suksesshëm në shkollë. Kujdes i veçantë duhet t’i kushtohet edukimit cilësor për fëmijët në shkollat tona, si dhe zhvillimit të tyre të përgjithshëm. Moduli: E drejta për Edukim – Edukimi Cilësor, ofron informata të përgjithshme mbi nocionin e edukimit cilësor në kontekstin e Kosovës, faktorëve të ndryshëm që përcaktojnë edukimin cilësor si dhe rolin e veçantë të mësimdhënësve dhe udhëheqjes arsimore. Për Kosovën, sfida është dyfishë: rritja e edukimit cilësor në kuadrin e decentralizimit të vazhdueshëm në një shtet shumë të ri, vetëm disa vite pas pavarësisë. Autonomia shkollore në rritje mund të jetë një mundësi e madhe për

⁴ Shiko shtojcën: Shtojca 5: Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës

⁵ Shiko shtojcën 9: Strategjia e sigurimit të cilësisë për arsimin parauniversitar të Kosovës

përmirësimin e edukimit cilësor në qoftë se autonomia do të çojë në decentralizimin e vendimmarrjes dhe financimit të shkollave, në më shumë pjesëmarrje të komunitetit, transparencë dhe garë.

Decentralizimi është një proces që realizohet në hapa të shumtë dhe ku ndryshimet vijnë gradualisht. Por është e qartë se kjo sjell ndryshime thelbësore në rolin e drejtorëve të shkollave: ndërsa ata ishin më parë, kryesisht drejtuesit e administratës së shkollave, ata tani e tutje nuk do të mbahen përgjegjës vetëm për menaxhimin e mirëfilltë të përditshëm të shkollës.

Rolet e ndryshme të drejtorit të shkollës:

Me rritjen e autonomisë, drejtorët e shkollave duhet të bëhen vizionar, planifikues arsimor, iniciatorë të zhvillimit shkollor, komunikues për të siguruar pjesëmarrjen e gjerë të komunitetit, përkrahës të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, moderatorët për akterët kyç të shkollës, menaxher për burime teknike dhe financiare, liderë për personelin dhe nxënësit e tyre të cilët marrin vendime të informuara mbi bazën e të dhënave, dhe drejtojnë shkollën e tyre në mënyrë efektive dhe strategjike në një kontekst gjithnjë e më konkurrues në mënyrë që të arrijnë rezultatet më të mira të mundshme për nxënësit e tyre me burimet në dispozicion.

Është me rëndësi të përmendet se MASH-i ka zhvilluar politika efektive arsimore dhe ka krijuar një kornizë të mirë të politikave për edukimin cilësor. Aspekte të rëndësishme janë në nivel qendror, miratimi i Ligjit të ri për Arsimin Parauniversitar, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë/PSAK⁶, Korniza e Kurrikulit të Kosovës/KKK⁷ dhe Plani Kombëtar i Veprimtë kundër Mungesës së Paarsyeshme nga Shkolla. Për më tepër, programet e ndryshme duhet të përmenden, si ato për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe stafit tjetër profesional në shkollë dhe sistemin e licencimit të mësimdhënësve. Kjo kornizë dhe përpjekjet për përfshirje dhe informim të vazhdueshëm të të gjithë akterëve përkatës, si dhe masa të tilla si për shembull duke bërë publike rezultatet e performancës së arsimit, mund të shërbejnë si një pikënisje për reflektim në kontekstin e Kosovës - në nivel qendror, komunal dhe të shkollës. Rritja e cilësisë në arsim është një përgjegjësi e përbashkët e të gjitha palëve relevante në fushën e arsimit në të gjitha nivelet.

1.1. Qëllimi i modulit

Qëllimi i të Modullit *E drejta për Edukim – Edukimi Cilësor* është që t'u sigurojë pjesëmarrësve të trajnimit njohuri të përgjithshme të aspekteve kryesore arsimore me ndikim të drejtpërdrejtë për një shkollë më të mirë, një shkollë e cila do të siguronte edukim cilësor për të gjithë nxënësit pavarësisht nga gjinia e tyre, përkatësia etnike, statusi social ose dallime të tjera në zhvillim. **Në këtë kontekst drejtori i shkollës ka një rol kryesor në realizimin e këtyre pritjeve.** Pozita e tij/saj është si një motor i një makine të madhe dhe të komplikuar. Nëse motori ndalon asgjë tjetër nuk mund të punojë, por nëse motori është i fortë, e gjithë makina ka shumë fuqi dhe mund të bëjë të ndodhin gjëra të mëdha.

6 Shih Shtojcën 6: Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021

7 Shih Shtojcën 7: Korniza e Kurrikulës së Kosovës (KKK)

1.2. Performanca e pritur

Pjesëmarrësit e trajnimit të udhëheqjes arsimore pritët që t'i arrijnë rezultatet themelore si në vijim:

1. Identifikojnë aspektet kryesore arsimore me ndikim të drejtpërdrejtë për një shkollë e cila do të siguronte edukim cilësor;
2. Dallojnë parimet e një shkolle të mirë të lidhura me standardet e cilësisë dhe zhvillimin e vizionit afatgjatë;
3. Zhvillojnë vision afatgjatë në bashkëpunim me mësimmshënësit, prindërit dhe Këshillin Drejtues të Shkollës;
4. Analizojnë sfidat specifike në shkollën ku punojnë;
5. Njihen me politikat arsimore dhe zhvillojnë praktika të udhëheqjes për arsim gjithëpërfirës;
6. Planifikojnë, zbatojnë, monitorojnë dhe vlerësojnë aktivitetet e tyre të përmirësimit të shkollave;
7. Komunikojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë efektive me stafin administrativ, mësimmshënësit, nxënësit, prindërit, komunën dhe komunitetin;
8. Zbatojnë menaxhim të efektshëm të personelit duke përfshirë planifikimin e nevojave të shkollës për personel deri tek vlerësimi i performancës dhe përvaktimi i nevojave për zhvillim profesional;
9. Zbatojnë në praktikë mjete administrative për të qenë më të suksesshëm në menaxhimin e kohës, dokumentacionit dhe në udhëheqjen e takimeve;

2. E drejta për edukim

E drejta në arsim tanimë është ripohuar disa herë që nga koha kur ishte shpallur për herë të parë në vitin 1948 përmes Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ)⁸, më vonë e konkretizuar në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve (KDF) në nenet 28 dhe 29. Këto traktate deklarojnë që të paktën arsimi fillor është falas dhe i detyrueshëm, ndërsa arsimi i mesëm dhe i lartë do të bëhen në mënyrë progresive të arritshme për të gjithë, edhe pse jo domosdoshmërisht falas. Neni 28 i KDF përcakton edukimin si e drejtë dhe rekomandon hapat për të arritur këtë të drejtë “në mënyrë progresive dhe mbi bazën e mundësive të barabarta”.

Hapat janë:

- ➔ Arsimi fillor duhet të jetë i detyrueshëm dhe falas për të gjithë. Arsimi i mesëm duhet të vihet në dispozicion dhe të jetë i arritshëm për çdo fëmijë, me ndihmën financiare në rast nevoje.
- ➔ Shtetet kërkohet që të inkurajojnë vijimin në shkollë dhe zvogëlimin e normës së braktisjes.
- ➔ Prej tyre gjithashtu kërkohet që të marrin masa për të siguruar që disiplina shkollore të administrohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës.
- ➔ Prej tyre gjithashtu kërkohet që të promovojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit.

Neni 29 ka të bëjë me synimin e arsimit në shkollë, i cili do të duhej të ishte:

- ➔ Që ta ndihmojë fëmijën në zhvillimin e “personalitetit” të tij/saj, talentit, si dhe aftësive mendore dhe fizike sipas potencialit të tyre të plotë”.
- ➔ Që ta zhvillojë respektin për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

Shkolla duhet t'i ndihmojë fëmijës gjithashtu që të përgatitet për “jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë së gjinive dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone”.

Së fundi, neni thekson rëndësinë e respektit të shkollës i cili është në rritje e sipër për mjedisin natyror.

'KATËR SHTYLLAT KRYESORE - DAPP'

Edhe pse forma e arsimit varet nga kushtet e veçanta të shtetit, arsimi duhet të përfaqësojë 5 tipare thelbësore sipas Komentit të Përgjithshëm nr. 13 të Komitetit të OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK 1999):

DISPONUESHMËRIA ndër të tjera i referohet ekzistimit të objekteve shkollore dhe programeve funksionale në numër të mjaftueshëm. Më tutje i referohet aspekteve si disponueshmëria e mësimit dhënësve të trajnuar, ujit të pijshëm dhe objekteve të tjera sanitare për vajzat dhe djemtë.

⁸ E drejta në arsim garantohet me nenin 26 të DUDNJ:




ARRITSHMËRIA kërkon mundësi jo-diskriminuuese dhe të barabarta për arsim. Ky tipar ka dimensionin e vetë fizik sa i përket shkuarjes në shkollë, dhe një dimension ekonomik sa i përket tarifave shkollore.

PRANUESHMËRIA ndërlidhet me cilësinë në arsim, që nënkupton metodat e mësimdhënies dhe kurrikulën. Këto duhet të jenë të duhura sa i përket kulturës dhe të jenë të ndërlidhura me nxënësit.

PËRSHTATSHMËRIA kërkon që arsimi dhe shkollimi të jenë fleksibil dhe në përputhje me gjendjen dhe nevojat e nxënësve. E drejta në edukim është vendimtare, pasi që nuk është vetëm një e drejtë në vetvete, por gjithashtu një faktor i favorshëm për një numër të drejtave të tjera. Është një instrument i rëndësishëm për të mbështetur njohuritë dhe realizimin e të drejtave të tjera të njeriut: një njeri i shkolluar është në një pozitë më të mirë që t'i mbrojë të drejtat e tij apo të saj, p.sh. e drejta e qasjes në shëndetësi, të drejtat politike si qytetarë ose e drejta për të punuar dhe zgjedhja e lirë e punësimit për të kërkuar të

drejtat e tyre dhe gjithashtu edhe për t'i shfrytëzuar ato. Prandaj edukimit cilësor konsiderohet si një “derë hapës” për të drejtat e tjera të njeriut dhe si një mjet për ta luftuar diskriminimin.



Për më tepër u bë gjithnjë e më e qartë se arsimi është një ndër faktorët qendror në zhvillimin ekonomik (shih më poshtë). Prandaj BE-ja ka programe të veçanta të të mësuarit gjatë gjithë jetës (TGJGJJ) me projekte të ndryshme për nxënësit, studentët, mësimmhënësit, profesorët, por edhe të rriturit me profesione të tjera (COMENIUS, ERASMUS, LEONARDO, GRUNDTVIG etj.).

DETYRË

JU LUTEM REFLEKTONI PËR VETËN TUAJ ME NDIHMËN E PYETJEVE NË VIJIM:

1. Pse është e drejta në edukim aq e rëndësishme për Kosovën, posaçërisht në shekullin 21?
2. Në kuptimin e DAPP-s, cilat prej tyre plotësohen në shkollën tuaj sot dhe cilat prej tyre paraqesin sfidë?
3. Në lidhje me të Drejtën në Arsim, me cilat probleme përballeni që janë më të rëndësishme sot sesa që kanë qenë në të kaluarën?

3. Korniza ndërkombëtare për edukim cilësor

Edukimi si “çelësi i zhvillimit” ka fituar rëndësi gjithnjë e më të madhe edhe në deklaratat ndërkombëtare dhe iniciativat zhvillimore në mbarë botën siç janë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) ose Iniciativa “Arsimi për të Gjithë”/APGJ.

3.1. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm/OZHQ

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 25 shtator 2015 miratoi Rezolutën 70/1 të titulluar: Transformimi i botës sonë - agjenda e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm. Kjo agjendë është një plan veprimi për njerëzit, planetin dhe prosperitetin. Gjithashtu, ajo synon të forcojë paqen universale në liri më të madhe. 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm⁹ dhe 169 shtete tregojnë shkallën dhe ambicien e kësaj agjende të re universale. Ata kërkojnë të ndërtojnë mbi Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe të përfundojnë atë që nuk kanë arritur. Ata kërkojnë të realizojnë të drejtat e njeriut për të gjithë dhe të arrijnë barazinë gjinore si dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave. Ato janë të integruara dhe të pandashme dhe i balancojnë tre dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm: atij ekonomik, social dhe mjedisor. Renditja e objektivave nuk nënkupton që njëri është më i rëndësishëm se objektivi tjetër.

Në përputhje me zhvillimet aktuale në sistemin arsimor në Kosovë, objektivat e mëposhtme, por jo vetëm ato, kërkojnë analizë të kujdesshme dhe sigurojnë integrimin në proceset e reja të zhvillimit të politikave:

Objektivi 4: Të sigurohet arsimi cilësor gjithëpërfshirës dhe i barabartë dhe të promovohen mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë;

Objektivi 5: Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat;

Objektivi 8: Promovimi i rritjes ekonomike të përkrahur, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimi i plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë;

Objektivi 16: Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

3.2. Iniciativa “Edukimi për të Gjithë”/EPGJ

Si rezultat i Konferencës Botërore të OKB-së për Arsimin për të Gjithë në vitin 1990 në Jomtien, Tajlandë, u themelua iniciativë mbarëbotërore “Arsimi për të Gjithë/APGJ”. Që atëherë, 189 vende kanë nënshkruar Iniciativën dhe u regjistruan për gjashtë objektiva:

⁹ Shih Shtojcën 3: Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

OBJEKTIVI 1

Zgjerimi dhe përmirësimi i kujdesit dhe arsimit gjithëpërfshirës të fëmijërisë së hershme, veçanërisht për fëmijët më të rrezikuar dhe të disfavorizuar.

OBJEKTIVI 2

Të sigurohet që deri në vitin 2015, të gjithë fëmijët, veçanërisht vajzat, fëmijët në rrethana të vështira dhe ata që u përkasin pakicave etnike, të kenë qasje, dhe ta përfundojnë edukimin fillor falas dhe të detyrueshëm të kualitetit të mirë.

OBJEKTIVI 3

Të sigurohet që nevojat e mësimi të të gjithë të rinjve dhe të rriturve të plotësohen përmes qasjes së barabartë në programe të përshtatshme të të mësuarit dhe shkathtësive për jetë.

OBJEKTIVI 4

Arritja e një përmirësimi prej 50 për qind në nivelet e shkrim-leximit për të rritur deri në vitin 2015, veçanërisht për gratë, dhe një qasje të barabartë në arsimin bazë dhe të vazhdueshëm për të gjithë të rriturit.

OBJEKTIVI 5

Eliminimi i pabarazive gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm deri në vitin 2005, dhe arritja e barazisë gjinore në arsim deri në vitin 2015, me një fokus në sigurimin e qasjes së plotë dhe të barabartë të vajzave dhe arritjen e një arsimit bazë të kualitetit të mirë.

OBJEKTIVI 6

Përmirësimi i të gjitha aspekteve të cilësisë së arsimit dhe sigurimi i përsosmërisë së të gjithave në mënyrë që të arrihen rezultatet e pranuar dhe të matshme të të mësuarit nga të gjithë, sidomos në shkrim lexim, aftësitë numerike dhe aftësitë esenciale të jetës.

3.3. Edukimi në BE

Në Traktatin e Romës 1957, aftësimi profesional është një sferë e veprimit të komunitetit. Në vitin 1992, arsimi është njohur si një sferë e kompetencës së Bashkimit Evropian.

Traktati deklaron: *“Komuniteti do të kontribuojë në zhvillimin e edukimit cilësor duke inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe nëse është e nevojshme, duke përkrahur dhe plotësuar veprimin e tyre, duke respektuar plotësisht përgjegjësinë e Shteteve Anëtare për përmbajtjen e mësimdhënies dhe organizimin e sistemeve arsimore dhe larminë e tyre kulturore dhe gjuhësore.”*


Në fakt “Traktati i Lisbonës, që është në fuqi që nga 1 dhjetori 2009, nuk ka ndryshuar dispozitat sa i përket rolit të BE-së në edukim dhe aftësim”¹⁰. Për të arritur këto qëllime, BE-ja ka një program të madh për arsim me COMENIUS për shkollat, ERASMUS për arsim të lartë, LEONARDO DA VINCI për shkollat e arsimit dhe trajnime dhe GRUNDTVIG për arsimin e të rriturve.

¹⁰ Shih Shtojcën: Shtojca 4: Traktati i Lisbonës

3.3.1. Objektivat e BE-së për edukim dhe trajnim (Standardet e krahasimit për vitin 2020)

Korniza Strategjike e azhurnuar për bashkëpunim Evropian në Edukim dhe Trajnim¹¹ (e njohur si ET 2020), hartuar nga Komisioni i Komuniteteve Evropiane dhe pajtuar nga Këshilli i Ministrave të Arsimit, shërben si mekanizëm kryesor për të parashtruar porositë e politikave arsimore të nivelit të lartë në Strategjinë Evropa 2020 të Bashkimit Evropian, për mobilizimin e politikave në të gjithë territorin për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse sociale.

Shtetet Anëtare dhe Komisioni duke punuar në këtë mënyrë, ato përdorin tregues dhe standarde krahasimi për të informuar dhe udhëzuar politik-bërjen e bazuar në dëshmi dhe si një mjet për të monitoruar progresin, si në nivel të BE-së ashtu edhe në nivelet kombëtare, drejt objektivave strategjike bashkërisht të pranura për arsim dhe trajnim.



¹¹ Objektivat e Trajnimit dhe Standardet e BE-s (krahasimi 2010-2020)^a, 2011

3.4 Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 – 2021

Prioritetet strategjike të PSAK-ut

Prioritetet strategjike të PSAK-ut 2017-2021 janë kryesisht tematike, ku vetëm dy prej tyre i referohen nënsektorëve të veçantë. Vendimi për të miratuar këtë qasje pasqyron çështjet e dyfishimit të identifikuara nga rishikimi i PSAK-ut 2011-2016, si dhe duke i nxjerr në pah prioritetet tematike të identifikuara tashmë nga Qeveria, dhe mbi të gjitha dëshira për të siguruar që PSAK-u i ri të ketë një orientim të qartë strategjik.

Fushat e Prioriteteve Strategjike janë paraqitur në Figurën 4 më poshtë:






Mineralët dhe shkëmbinjve


SHKËMBINJËT VULLKANIKË



1) Obsidian




2) Andezit



3) Basalt


SHKËMBINJËT SEDIMENTARË




1) Gips




2) Karbonat



3) Silt



4) Argjil



1) Marmar




2) Gips




3) Karbonat



4) Silt



5) Argjil



6) Silt

7) Argjil

SHKËMBINJËT METALORËZUES



1) Sulfur



2) Karbonat



3) Sulfur



4) Karbonat

Qymyri Kjo llojsh e arës dhe e fortë formohet atëherë kur depozitohet rrezet e rrezatimit nën tokë. Tërthi është një lloj rrezet i pastruar, i formuar nga llojet e ndryshme të rrezatimit. Me kalimin e kohës vitet, pesha e rrezatimit nga atëherë e sipërme e atëherë rrezet përbëhet e shpërndarë fillimisht ajo shpërndarë në një mineral të quajtur lloje dhe se fundi në qymyr.

4. Cilësia në arsim: Përkufizimi dhe faktorët përcaktues

Cilësia në arsim është një koncept që i referohet një sërë faktorëve; pasi që çdo shtet është specifik, gjithashtu sa i përket sektorit të arsimit, me sisteme të ndryshme të trajnimit të mësimdhënësve, menaxhimit dhe udhëheqjes, të përfshira në një kontekst të veçantë kulturor, politik, ekonomik dhe shoqëror, është e pamundur të paramendohet se do të ketë një model ose një rrugë të vetme për t'u ndjekur.

Por si mund ta dini se një sistem arsimor ka një cilësi të lartë pavarësisht se në cilin shtet ndodhet? Cilët janë faktorët kryesor të cilësisë së arsimit? Cilësia e arsimit varet nga katër faktorët e mëposhtëm:

- 1 Standardet ndërkombëtare të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- 2 Edukimi profesional i mësimdhënësve dhe trajnimi profesional i mësimdhënësve në shërbim (Standardet Ndërkombëtare).
- 3 “Nuk ka certifikatë pa qasje” - kjo do të thotë që rezultatet (provimet) e shkollës duhet t'u ndihmojnë nxënësve që të jenë të kualifikuar dhe të pranuar. Përfundimi i shkollës nga nxënësit duhet të jetë një hapje e derës; “Çfarë duhet bërë tjetër?” punë ose çfarë duhet studiuar; diplomimi duhet të jetë një portë e dobishme për zhvillimin e mëtejshëm individual.
- 4 Sistemi fleksibil i arsimit me module për të arritur “të mësuarit gjatë gjithë jetës” si një linjë vertikale arsimore për çdo biografi.

Secili shtet duhet të hulumtoj gjendjen aktuale të cilësisë së arsimit dhe të gjejë pikat e forta dhe të dobëta ekzistuese në lidhje me cilësinë e arsimit në vetë kontekstin e tyre të brendshëm. Bazuar në të dhënat e vlefshme arsimore ata duhet të zhvillojnë sistemin e tyre arsimor në bashkëpunim me universitetet dhe ekonominë. Është e rëndësishme që arsimit shkollor të punojë ngushtë me të gjithë “pranuesit” e nxënësve. Prandaj është gjithashtu e nevojshme që të gjitha llojet e ndryshme të shkollave të punojnë së bashku, siç janë shkollat fillore me shkollat e mesme dhe shkollat e mesme me shkollat profesionale. Politika e arsimit duhet të mendojë për arsimin nga niveli parashkollor deri te ai universitar dhe te shkollat profesionale, por edhe për trajnimin e të rriturve (edukimin qytetar). Prandaj, Bashkimi Evropian ka një program të gjerë për të mësuarit gjatë gjithë jetës¹², i cili financon projekte për arsimin shkollor, arsimin e lartë, arsimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin e të rriturve.

¹² Mund të lexoni me shume rreth programit evropian në faqen e internetit të Komisionit Evropian për shembull: http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-programme/doc78_en.htm.

5. Edukimi cilësor dhe zhvillimi ekonomik

Përveç se arsimit është e drejtë themelore e njeriut shumë herë e konfirmuar dhe e konkretizuar, arsimit është gjithashtu një motor për zhvillimin ekonomik. Statusi i përgjithshëm i arsimit të një popullsie në një shtet përcakton edhe nivelin e pritur të arsimit në fuqinë punëtore të shtetit, që nënkupton personat që punojnë si të punësuar ose të vetëpunësuar, sipërmarrësit, menaxherët, zyrtarët dhe shumë e shumë të tjerë.

Fakti që njerëzit janë pasuria më e rëndësishme nuk është tashmë i ri: termi “shoqëri e dijes” i referohet një shoqërie dhe ekonomie të bazuar në njohuritë e popullit të tyre.

Në sistemet e tregtisë në mbarë botën po bëhet më pak e rëndësishme se ku gjinden burime natyrore: më e rëndësishme është nëse një vend ka njerëz që dinë dhe kuptojnë se si duhet t'i përdorin këto burime për rezultate optimale, të shpikin njohuritë, teknikat dhe proceset e reja dhe t'i përdorin ato në të njëjtën kohë për të mirën individuale dhe për të mirën e shoqërisë në përgjithësi.

Ky është një lajm shumë i mirë - për të gjitha vendet! Sepse ne nuk mund ta ndryshojmë përbërjen gjeologjike të tokës dhe gurit, ne mund ta lëvizim nivelin e arsimit të përgjithshëm në një shoqëri në mënyrë të konsiderueshme brenda një periudhe të caktuar kohore. Aftësitë njohëse të popullsisë janë një faktor kryesor për rritjen ekonomike.

Pasi që edukimi cilësor ka një efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të një vendi, ai do të duhej të ishte në qendër të raportimit e jo edukimi sasior.

Për të ngritur nivelin e arsimit nuk është e mjaftueshme vetëm që të zgjatet koha për arsim, numri thjesht i viteve shkollore. Mirëqenia ekonomike nuk mund të afirmohet nëpërmjet zgjatjes thjesht të viteve të arsimit të detyrueshëm, ose rritjes së numrit të nxënësve që e përfundojnë arsimin e lartë. Zgjatja sasiore e arsimit madje mund edhe t'i shterojë ato fonde të pakta të cilat do ishin të nevojshme që urgjentisht të punohet në cilësi.

Prof Eric A. Hanushek nga SHBA dhe Prof Ludger Eöckmann nga Gjermania kanë analizuar së bashku lidhjen midis edukimit (bazuar në testet ndërkombëtare) dhe suksesin ekonomik të vendeve të shumta në mbarë botën. Rezultatet tregojnë se dallimet në të arriturat në mësim kanë më shumë rëndësi për të shpjeguar ndryshimet ndërmjet vendeve në rritje ekonomike, sesa ndryshimet në numrin mesatar të viteve të shkollimit, ose normat e regjistrimit në shkollë.

Bazuar në hulumtimet e tyre, ata theksojnë se çfarëdo qasje në drejtim të cilësisë më të mirë në edukim ka nevojë për të trajtuar faktorë të ndryshëm në të njëjtën kohë; nuk është e mjaftueshme dhe as e mundur që të rriten aftësitë njohëse, pa forcuar në të njëjtën kohë strukturën themelore të shkollave!

Nga kjo analizë, perceptimet më të rëndësishme janë:

- Cilësia e trajnimit të mësimdhënësve dhe performancës fuqishëm ndikon në rezultatet e nxënësve.



Edukimi cilësor—i matur me atë çka njerëzit dinë—ka efekte të fuqishme mbi të mësuarit individual, mbi shpërndarjen e të ardhurave dhe mbi zhvillimin ekonomik.”

(Hanushek/Woeßmann, 2007, faqe 1)

- Zhvillimi i sistemeve të llogaridhënies në bazë të testeve të të arriturave njohëse të nxënësve për të dhënë stimuj për performancë të mirë, si për personelin e shkollës ashtu edhe për nxënësit.
- Rritja e vendimmarrjes lokale apo autonomisë lokale, e ndërlidhur me llogari-dhënien, mund t'i lehtësojë këto përmirësime.

Këto perceptime janë ndërhyrje të mëdha në sistemin arsimor dhe ato do të diskutohen në më shumë hollësi më poshtë. Përveç cilësisë së arsimit dhe të kualifikimit të mëvonshëm të fuqisë punëtore, është edhe një aspekt tjetër i zhvillimit ekonomik në të cilin arsimit mund të luajë një rol qendror. Në botën e sotme asnjë ekonomi e vetme nuk mund të përparojë vetëm: në botën e sotme, të gjitha vendet janë të ndërlidhura dhe të varura nga njëri tjetri. Prandaj bashkëpunimi ekonomik dhe investimet e huaja të drejtpërdrejta janë të rëndësishme për çdo vend për të plotësuar burimet e veta dhe për të siguruar punësim dhe perspektivë për të gjithë qytetarët.

Në mbarë botën, të gjitha vendet janë duke garuar për investimet e huaja direkte për të përparuar ose nganjëherë thjesht për të mbijetuar - shumë vende përpiqen të përfitojnë investimet e kompanive të huaja në vendin e tyre, duke ofruar stimuj si zvogëlimi i taksave apo infrastrukturë të mirë. Po aq e rëndësishme sa këto stimuj është edhe prania e fuqisë punëtore të kualifikuar¹³, mundësia e një sistemi të besueshëm ligjor dhe qetësia e qëndrueshme sociale në vend.

13 Shih Akin, M., Vlad, V., 2011, "Raporti ndërmjet arsimit dhe Investimeve të Huaja Direkte" në Zhurnaln Evropian të Studimeve Ekonomike dhe Politike / ejepe-4(1).2011

Rreziku për prishjen e rendit shoqëror është më i ulët në shoqëritë që synojnë një shoqëri gjithëpërfshirëse, bazuar në respektin dhe tolerancën e ndërsjellë në mes të grupeve të ndryshme popullsisë, duke ofruar qasje të barabartë në shërbime të tilla si edukimi cilësor për të gjithë.

Edukimi mund të funksionojë si një “barazues”!

Në kuadër të hulumtimit të tyre për arsim dhe zhvillim ekonomik, Prof Hanushek dhe Prof Woelßman theksojnë: “Zvogëlimi i pabarazive në qasje dhe në cilësinë e arsimit, janë dy objektiva që duhet të realizohen njëkohësisht që çfarëdo reforme e arsimit të jetë e suksesshme.” (Hanushek / Woelßmann, 2007)

Zhvillimi i burimeve njerëzore është një karakteristikë shumë e rëndësishme e çdo vendi. Kosova ka një popullsi të re, kjo paraqet një privilegj dhe një detyrim të madh në të njëjtën kohë!

Pyetjet për reflektim dhe diskutim:

1. Në dritën e rëndësisë së edukimit cilësor, përse mendoni se pritjet për drejtorët e shkollave janë rritur aq shumë? Si ndikon kjo tek ju?
2. Cilat janë intervenimet kryesore për të arritur edukimin cilësor?
3. Nëse vendi si Kosova dëshiron të arrij edukimin cilësor, çka duhet të ndryshohet?
4. Si mund ta mbështetni këtë rrugë drejtë edukimit cilësor?

6. Nga Edukimi sasior në Edukim cilësor

Fokusi në arsim nxiti përpjekjet në mbarë botën për të përmirësuar arsimin për të gjithë fëmijët. Meqë këto programe ndërkombëtare dhe kombëtare u monitoruan vazhdimisht dhe u vlerësuan rregullisht, të kuptuarit tonë mbi arsimin u thellua dhe një sërë hulumtimesh të kohëve të fundit

Ka pasur dhe në disa vende ende është supozimi themelor që arsimi forcohet kur fëmijët kanë mundësi të qëndrojnë më gjatë në shkollë: kohëzgjatja dhe sasia e arsimit janë parë si faktori kryesor për arsimim të mirë.

Hulumtimet tani na mësojnë se koha është një faktor i rëndësishëm, por më e rëndësishme është **ajo çka në fakt ndodh** në këtë kohë: në disa vende të botës fëmijët qëndrojnë në klasa për vite e vite por prapëseprapë matur nga rezultatet e provimeve, nuk mësojnë mjaft, ndoshta edhe mezi dinë shkrim lexim pas disa viteve të shkollimit.

Kjo ka ndryshuar perceptimin tonë: ndërsa koha është e rëndësishme për arsimin, ajo që me të vërtetë vlen është **se çfarë dhe si mësojnë fëmijët në të vërtetë** gjatë kësaj kohe, pra cilësia e arsimit!

Kjo ka qenë pika fillestare e shqyrtimit të faktorëve që përcaktojnë cilësinë e arsimit.

Prandaj shkollat kanë një përgjegjësi të madhe. Ekzistojnë pritje të mëdha nga politika, grupe të ndryshme të shoqërisë, por edhe nga prindërit dhe ekonomia. Ata të gjithë duan që të rinjtë të jenë të kualifikuar mirë, të cilët nuk qëndrojnë shumë gjatë në shkollë, por dalin nga ajo me nota të mira në provime, njohuritë praktike dhe teorike dhe standardet ndërkombëtare të cilësisë. Pra, politikëbërësit në vende të ndryshme të botës sigurojnë politika dhe plane përkatëse për arsim cilësor. Por, meqë burimet janë të kufizuara, është e rëndësishme që të merren vendime të mirinformuara bazuar në të dhënat e arsimit.

Futja në përdorim e Sistemit Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA) është një hap i rëndësishëm për të pajisur vendimmarrësit në nivelin qendror, komunal dhe shkollor me njohuritë e nevojshme të detajuara që nevojiten për të menaxhuar arsimin në mënyrë efikase dhe efektive.

Aktiviteti:

Në lidhje me katër faqet e mëparshme, ju lutemi shqyrtoni dhe pastaj diskutoni pyetjet e mëposhtme:

- 1 A ka shkolla juaj ndonjë sfidë gjinore? Si do ta dinit nëse do të kishte?
- 2 Me cilat sfida përballet shkolla juaj sa i përket objektivave 1, 2 dhe 5 të Edukimit për të Gjithë?
- 3 Kur i shqyrtoni objektivat e BE-së, a mund të identifikoni tre pikat e forta të shkollës suaj¹⁴?
- 4 Si do ta dinit se sa mirë është duke vepruar shkolla juaj në krahasim me standardet e BE-së?

Një studim i realizuar në katër komuna në Kosovë për nivelin e kënaqëshmërisë së prindërve, nxënësve dhe mësimdhënësve me administratën e shkollës dhe mundësitë e pjesëmarrjes në shkollë, tregon që rreth 40% e nxënësve nuk kanë marrë arsim cilësor¹⁵. Bisedat e mëposhtme janë disa shembuj të deklaratave të pjesëmarrësve të gjetura në këtë studim.

14 Ju lutemi vini re: Cilësia e shkollave të një vendi është performanca e përgjithshme e të gjitha shkollave të saj; Prandaj, është e rëndësishme performanca e çdo shkolle individuale.

15 Për më shumë detaje shih raportin e studimit të kushtit fillestar: Ardit Bejko (2011): Niveli i kënaqësisë së prindërve, nxënësve dhe mësuesve me administratën e shkollës dhe mundësitë për të marrë pjesë në shkollë, IQ Consult Prishtina

RESPUDENTËT

“NE MEZI E KEMI PËRFUNDUAR SHKOLLËN; NUK KEMI MËSUAR ASGJË. TANI PO E SHOH NË PUNË SE KEMI MUNGESË TË MË SHUMË SHKATHTËSIVE DHE NJOHURIVE.”

“AJO QË UNË E DI ËSHTË SE FËMIJËT E MI PO SHKOJNË RREGULLISHT NË SHKOLLË, POR NUK E DI A PO I MËSOJNË MIRË A JO. A NUK ËSHTË KJO PUNË E MËSUESVE A?”

“PO NE KEMI DISA MËSIMDHËNËS QË NA MËSOJNË ME METODA TË REJA, NE MËSOJMË ME KËNAQËSI. DO TË ISHTE ARGËTUESE NËSE TË GJITHË MËSIMDHËNËSIT DO TË MËSONIN ASHTU.”

“NE PO SYNOJMË QË TA RRSIM CILËSINË, GJË QË VARET NGA SHUMË FAKTORË, DHE KJO NUK ËSHTË NJË PUNË E LEHTË.”

7. Masat e sistemit cilësor

Hulumtuesit analizuan të dhënat e të gjithë botës për të gjetur një mënyrë për të matur cilësinë në arsim, duke u përpjekur që të identifikojnë faktorët që duket të funksionojnë si një tregues për të gjithë sistemin, për të gjetur një “përfaqësues” për cilësinë e arsimit, d.m.th një tregues që është i rëndësishëm, i matshëm, lehtësisht i arritshëm dhe mund të matet me kalimin e kohës për të dokumentuar ndryshimin.

Hanushek dhe Woeßmann gjetën një tregues të tillë në performancën e nxënësve në matematikë dhe shkencë, që mundëson krahasimin e situatës në vende të ndryshme dhe progresin me kalimin e kohës brenda një vendi:

“Masa e cilësisë së arsimit është **një mesatare e thjeshtë e pikave të matematikës dhe shkencës** nga testet ndërkombëtare, që interpretohet si një përfaqësim për performancën mesatare arsimore.... Kjo masë përfshin aftësitë njohëse të përgjithshme, e jo vetëm ato të zhvilluara në shkolla. Kështu, pavarësisht nëse aftësitë zhvillohen në shtëpi, në shkolla, apo diku tjetër, ato përfshihen në analiza të zhvillimit. “(Hanushek / Woeßmann, 2007, f.5)

Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve/PVNS vlerëson shkallën në të cilën nxënësit 15 vjeçar pranë përfundimit të arsimit të detyrueshëm kanë përfituar njohuritë dhe aftësitë thelbësore për pjesëmarrje të plotë në shoqëri. Treguesit kontrollojnë përvetësimin e matematikës dhe shkencës dhe që nga viti 2003 si shtesë, zgjidhjen e problemeve.

Ndërsa ne punojmë me një tregues për zhvillim njohës, ne kurrë nuk duhet të harrojmë se edukimi cilësor është më shumë se zhvillimi njohës: Për të kuptuar më mirë analizat dhe planifikimin, ne do të duhet të punojmë me një seri treguesish për dimensionet e ndryshme të arsimit. Kjo është e nevojshme sepse standardet arsimore kanë për qëllim që të zhvillojnë dhe mbështesin aftësitë e ndryshme të nxënësve. Zakonisht ne ndryshojnë në tre apo katër fusha të aftësive:

- 1 aftësitë njohëse të cilat mund të vlerësohen me teste kombëtare dhe ndërkombëtare
- 2 Metodatat, aftësitë (shkathtësitë) si paraqitja ose strategjitë kreative për të gjetur zgjidhje për problemet, kjo fushë e aftësive gjithashtu mund të testohet dhe vlerësohet
- 3 aftësitë sociale dhe personale për të zhvilluar karakterin e nxënësve (në disa vende janë dy fusha të ndryshme të aftësive)

Aftësitë personale dhe sociale nuk janë të lehta për t’u vlerësuar, sepse është vështirë për të gjetur tregues për këto aftësi. Megjithatë çdo shkollë duhet të mendojë për atë se si mësuesit mund të mbështesin këto aftësi. Pra, është e nevojshme për të menduar rreth:

- Si duhet të jetë arsimiti në shkollë që nxënësit të kenë mundësi të zhvillojnë karakterin dhe personalitetin e tyre individual?
- Çfarë lloj mësimdhënie na duhet? Çfarë lloj masa na duhen për të mësuar?
- Çfarë lloj trajnimit të mësimdhënësve brenda shërbimit dhe arsimimi i mësuesve na duhet?

Cilësia e arsimit i përket ngushtë cilësisë së shkollës. Në Kosovë, cilësia e shkollës është e organizuar rreth pesë fushave të cilësisë, të cilat përfaqësojnë pesë dimensionet e zhvillimit të shkollës, ku secila shkollë pritet të kontribuojë dhe të përmirësohet vazhdimisht. Këto fusha të cilësisë janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ përkatës për Planifikimin e Zhvillimit të Shkollës dhe Kornizën

për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës. Fushat e cilësisë së shkollave në Kosovë janë:

- 1 Rezultatet dhe sukseset – performance nxënësve,
- 2 Mësimdhënia dhe mësimnxënia,
- 3 Mjedisi dhe kultura e shkollës,
- 4 Udhëheqja dhe menaxhimi,
- 5 Zhvillimi profesional i mësimdhënësve.

Fushat e cilësisë dhe cilësia e shkollës në përgjithësi do të diskutohen më tej në Modulin e dytë - Shkolla e mirë. Gjithashtu, në Modulin e tretë - Planifikimi i Zhvillimit të Shkollës - këto fusha të cilësisë do të prezantohen dhe diskutohen si pjesë e procesit të planifikimit të përmirësimit të shkollave në shkollat e Kosovës. Për më tepër, secili kapitull ka për qëllim të mbështesë drejtorët e shkollave, pjesëmarrësit e këtij programi, për të përmirësuar cilësinë e shkollës. Prandaj, secili kapitull do të përmirësojë në mënyrë specifike punën e planifikimit dhe zhvillimit të pjesëmarrësve drejt zhvillimit të shkollës dhe përmirësimit të cilësisë së shkollës. Por faktorë të veçantë për të vërtetuar cilësinë e arsimit janë rezultati dhe sukcesi, profesionalizimi dhe kultura e të mësuarit.



DETYRË:

Analizoni profilin e shkollës; Ilustroni me shembuj. Cila nga fushat e cilësisë së shkollës mund të përmirësohet pa burime financiare shtesë duke arritur kështu një cilësi më të lartë të arsimit?

8. Të kuptuarit e edukimit cilësor


Për fat të keq nuk ka asnjë recetë të lehtë për edukimin cilësor pasi që cilësia është rezultat i shumë faktorëve që janë të ndërvarur dhe që ndikojnë reciprokisht.

Kontribuuesit e përgjithshëm për përmirësimin e cilësisë së arsimit përfshijnë:

- Trajnimi efektiv i mësimitdhënësve të mbështetur nga sistemi efikas i licencimit të mësimitdhënësve;
- Praktika efektive e mësimitdhënies;
- Udhëheqje dhe menaxhim efektiv;
- Pritja e transparencës përmes zbulimit publik të arritjeve arsimore të shkollave dhe mësimitdhënësve;
- Forcimi i llogaridhënies së sektorit të arsimit tek palët e interesit (interesat individuale) dhe komuniteti në përgjithësi;

Kontrolli shkollor lokal dhe përfshirja e komunitetit nëpërmjet shoqatave prindërore.

Dëshmitë nga hulumtimi nënvizojnë se forcimi i mësimitdhënies dhe mësimitnxënies në klasë është një nga faktorët më të rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së arsimit. Por ajo që ndodh në një klasë nuk është e pavarur nga ajo që ndodh në shkollë ose në sektorin e arsimit. Pra, nëse i vendosim nivelet e ndryshme të edukimit në qarqe koncentrike me atë më të rëndësishmen në qendër dhe akterët e kontekstit të pozicionuar në përputhje me këtë, do të dalim me tabelën e mëposhtme:



Në qendër të edukimit janë nxënësit dhe zhvillimi gjithëpërfshirës i tyre: Nxënësit nuk vijnë në shkollë si një fletë e bardhë e letrës, por ata tashmë ka fituar njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet nga shtëpia dhe nga komuniteti në përgjithësi.

Kur nxënësit hyjnë në shkollë, ata e kanë tashmë një perceptim të statusit të tyre dhe kanë pritje: janë optimistë dhe shpresojnë në përpjekjet e tyre, ose kanë frikë nga dështimi, ata ose mendojnë se shkollë është një vend i mrekullueshëm ose një vend i tmerrshëm.

Është detyrë e shkollës për të mirëpritur të gjithë nxënësit e ndryshëm, t'i bëjë ata të ndjehen të rehatshëm në mënyrë që ata të mund të mësojnë dhe t'i zhvillojnë potencialet e tyre. Në Modulin e dytë - Shkollat e mira - ne do të diskutojmë mënyra të ndryshme se si shkollat mund të përballojnë sfidat për të ofruar mundësitë mësimore për të gjithë fëmijët me qëllim të përmbushjes së potencialeve individuale, promovimin sistematik të zhvillimit të kompetencave dhe shkathhtësive, duke mundësuar të mësuarit e vetëdrejtuar dhe vetorganizuar, që janë të rëndësishme për karrierën shkollore dhe profesionale. Sigurimi i përvojave pozitive për mësim për të gjithë fëmijët është një karakteristik e rëndësishme e "shkollave të mira".

Kjo është sfidë për shumë mësimdhënës. Kërkohen më shumë se vetëm njohuritë e mira të lëndës që një mësues të mund të zotërojë larminë e fëmijëve në një klasë, që jetë në gjendje të shpjegojë dhe t'i inkurajojë nxënësit për të eksploruar; që të krijojë një mjedis miqësor për nxënës që përqafojnë të gjithë nxënësit e ndryshëm me përparësitë dhe dobësitë e tyre të ndryshme: që të krijojë një mjedis të mirë dhe stimulues për mësim dhe zhvillim. Ka nevojë për mësimdhënës më shumë dhe më mirë të trajnuar. Vendet që kanë arritur standarde të larta të të mësuarit, kanë investuar në mënyrë të qëndrueshme në profesionin e mësimdhënies. Modele të trajnimit për mësimdhënës duhet të rishikohen, për të përforcuar trajnimin me bazë shkolle para dhe gjatë shërbimit.

Mësimi i mirë përsëri varet nga një numër faktorësh të përshtatshëm.

Disa nga ato më të rëndësishmet janë:

KUALIFIKIMI I MËSIMDHËNËSIT: të gjitha studimet në 10 vitet e fundit në lidhje me faktorët më të rëndësishëm të arsimit të mirë kanë të njëjtin rezultat (Helmke, 2007). Mësimdhënësi si person është i rëndësishëm për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Profesionalizmi i tij/saj si një iniciator, përkrahës, moderator, këshilltar, udhëheqës etj, është një faktor i përcaktuar për cilësi të lartë.

KOHA E TË MËSUARIT. Koha e mësimdhënies është një element thelbësor për suksesin: standardi i pranuar gjerësisht prej 850-1,000 orë mësimi në vit për të gjithë nxënësit nuk është arritur në shumë vende. Rezultatet e testit tregojnë qartë se sasia e kohës së klasës e kaluar në matematikë, shkencë dhe gjuhë, fuqishëm ndikon në performancën në këto lëndë. Por mësimdhënësit gjithashtu kanë nevojë për njohuri në menaxhimin e klasës, sepse shpesh koha nuk përdoret vërtetë për të mësuar, por për menaxhim.

LËNDËT PËRKATËSE/THEMELORE TË KURRIKULIT. Shkrim leximi është një mjet kritik për përvetësimin e lëndëve të tjera. Leximi duhet të konsiderohet një sferë prioritare në përpjekjet për të përmirësuar cilësinë e arsimit bazë, në veçanti për nxënësit me prejardhje të disfavorizuar. Lëndë të tjera të tilla si aftësia për vepruar me numra dhe shkenca konsiderohen njëlloj të rëndësishme dhe kështu duhet të përqendroheni më shumë në mënyrën se si të miratohet kurrikula që është relevante për nevojat dhe pritjet e nxënësve.

METODAT E MËSIMDHËNIES/PEDAGOGJIA. Shumë stile që përdoren rëndom në mësimdhënie nuk u shërbejnë mirë fëmijëve: ato janë shpesh shumë të ngurta dhe mbështeten kryesisht në të mësuarit përmendsh, duke i vënë nxënësit në një rol pasiv. Shumë studiues arsimor mbrojnë një qasje të mësimdhënies që kombinon mësimin direkt, praktikë të udhëhequr dhe të mësuarit e pavarur.

POLITIKA E PËRFSHIRJES: Përfshirja është një aspekt i rëndësishëm i edukimit: Ajo synon drejt favorizimit të mësuesve dhe nxënësve që të ndihen rehat me diversitetin dhe për ta parë atë si një sfidë dhe pasurim të mjedisit mësues, më shumë sesa një problem.

MATERIALET E MËSIMDHËNIES DHE MËSIMNXËNIES. Cilësia dhe disponueshmëria e materialeve mësimore fuqishëm ndikon në atë çka mësimeve mund të bëjnë. Mungesa e teksteve shkollore, materiale të mira të mësimeve dhe mësimeve është një pengesë e madhe në arritjen e rezultateve të mira.

INFRASTRUKTURA FIZIKE/OBJEKTET. Renovimi dhe ndërtimi i klasave është i nevojshëm në shumë vende. Uji i pastër, tualete dhe qasje për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore janë me rëndësi jetike.

UDHËHEQJA. Qeveritë qendrore duhet të jenë të gatshme që t'i japin liri më të madhe shkollave, me kusht që burimet e duhura të jenë në dispozicion dhe që rolet dhe përgjegjësitë të jenë të përcaktuara qartë. Drejtorët kanë një ndikim të madh në cilësinë e shkollave.

Përtej nivelit të shkollës janë faktor të kontekstit, si gjendja ekonomike, politikat kryesore kombëtare, strategjitë e arsimit, pritjet publike nga arsimit, standardet kombëtare, kërkesat e tregut të punës etj. Këta faktorë përcaktojnë kontekstin në të cilin mësimeve dhe mësimeve zhvillohen.

Kjo kornizë¹⁶ tregon faktorët e ndryshëm që ndikojnë në cilësinë e arsimit.

Listat e faktorëve të dhënë si shembuj janë të gjata: disa prej tyre mund të jenë të rëndësishme në një vend dhe jo të rëndësishme në një tjetër.

Prandaj, çdo vend duhet të analizojë dhe të vendosë për faktorët më të rëndësishëm në situatën e vet specifike.

Ky proces ka nevojë për udhëheqje të fuqishme! Angazhimi i lartë politik për arsim më të mirë në nivel qendror, komunal dhe të shkollës është një parakusht.

¹⁶ Bazuar në GMR 2005




S... P... E...
"FILM" "RAKOVINA"
PRISHINE

Ju lutemi t'i gjeni faktorët e përmendur më lart në grafikun më poshtë



Mësimdhënia e cilësisë së mirë është motivuese, është efektive në performancë dhe promovon zhvillim.

Faktorët e identifikuar kryesorë që ndikojnë në rritjen e performancës nxënësve dhe rezultatet e cilësisë së arsimit janë të paraqitur në tabelën e më poshtme.



Instituti Ifo në Mynih përmes hulumtuesve dhe bashkëpunëtorëve të tij të shumtë, të tillë si Jens Ruhose, ka dhënë kontribut të vlefshëm për atë se çka është edukimi cilësor dhe si duhet të jetë ai. Cilësia e arsimit është një koncept kompleks - shumë faktorë kontribuojnë në një cilësi të lartë të arsimit. Cilësia e arsimit matet në mësimin e nxënësve, veçanërisht në lexim dhe matematikë: një sistem arsimor me cilësi të lartë u ndihmon nxënësve të arrijnë rezultate të larta të të nxënësve. Pra cilët janë faktorët kryesorë të cilësisë së arsimit dhe sa të rëndësishëm janë ato?

Hulumtimet janë fokusuar në tri fusha kryesore:

BURIMET E SHKOLLAVE

Hulumtimet kanë treguar se burimet janë të rëndësishme, por jo qenësore. Natyrisht - në një klasë me 40 e më shumë nxënës, të nxënësve do të reduktohet për shkak të grupit të madh, por përndryshe

madhësia e klasës, që është numri i nxënësve për mësimdhënës, nuk është aq e rëndësishme - një reduktim mesatar i raportit nxënës-mësimdhënës nga 1:26 në 1:22 nuk tregon shumë ndikim. Pra, vetëm burimet nuk janë një zgjidhje gjithëpërfshirëse.

INSTITUCIONET

Është e rëndësishme që mësimdhënësit dhe shkollat të mbajnë përgjegjësi për të arriturat. Provimet përfundimtare mund të sigurojnë standarde të cilësisë dhe të rrisin arritshmërinë e nxënësve. Autonomia e shkollave është vërtetuar të jetë e dobishme në vendet e zhvilluara, por ajo mund të jetë e dëmshme në vendet në zhvillim; kur mungojnë sisteme të mira vlerësimi dhe monitorimi, autonomia e shkollës mund të jetë e rrezikshme. Së fundmi, dhënia e mundësive prindërve për të zgjedhur nga shkolla të ndryshme çon në krijimin e një sistemi konkurrues dhe në këtë mënyrë në cilësinë më të mirë të shkollës.

CILËSIA E MËSIMDHËNËSVE

Cilësia e mësimdhënësve është përcaktuesi kryesor për performancën e nxënësve - është mësimdhënësi ai mbi të cilin bie barra në klasë. Ekzistojnë disa dëshmi se rritja e performancës së nxënësve rritet për shkak të stimuljeve për mësimdhënësit, veçanërisht në vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion. Thënë shkurt, arsimit ka një ndikim të jashtëzakonshëm në rritjen ekonomike dhe se cilësia e arsimit është më e rëndësishme se sasia.

Prandaj është e nevojshme të përqendrohemi në rezultatet (= të nxënësve real) dhe jo në arritjet shkollore (certifikatat). Është e nevojshme të zhvendoset fokusi në institucionet, stimujt dhe mbi të gjitha në cilësinë e mësimdhënësve.

Pyetjet për diskutim:

1. Cilët janë faktorët më të rëndësishëm mundësues për nxënësit në Kosovë?
2. Cilët nga këta faktorë mundësues kontrollohen apo ndikohen nga shkolla?
3. Rendisni faktorët mundësues të emëruar në tabelë sipas rëndësisë së tyre për shkollën tuaj.
4. Në krahasim me faktorët e ndryshëm kontekstualë që kontribuojnë në cilësinë e arsimit siç theksohet nga hulumtimet e ndryshme të dhëna më sipër, cilët mendoni se janë tre faktorët më të rëndësishëm 'të kontekstit' në Kosovë?

8.1. Roli i udhëheqjes së shkollës në edukimin cilësor

Me përmirësimin e vazhdueshëm të politikave arsimore, udhëheqësit arsimor krijojnë dhe ofrojnë mundësi për shumë fëmijë që të përfitojnë, fitojnë njohuri, zhvillojnë aftësitë thelbësore për jetë dhe qëndrimet themelore për jetën e tyre. Shkolla të suksesshme dhe edukimi cilësor vijnë si rezultat i udhëheqjes cilësore dhe t'u përkushtuar punës. Nuk mund të ketë cilësi në shkollë pa udhëheqje dhe qeverisje efektive dhe cilësore. Udhëheqësit efektiv arsimor i ndihmojnë shkollat e tyre për të përgatitur një vizion i cili ngërthen përkushtim të nivelit të lartë në mësimdhënie dhe mësimnxënie - si një parakusht për arsim cilësor në shkollat e tyre. Drejtorët e shkollave kanë një rol vital në arritjen e një cilësie të mirë arsimore: Ata janë udhëheqës të disa prej faktorëve më të rëndësishëm favorizues dhe të kontekstit (që u paraqiten më lart) dhe mund të ndikojnë procesin mësimor në klasë në mënyrë efektive. Drejtorët e shkollave tashmë marrin një rol kyç në sistemin arsimor, i cili nuk është i kufizuar vetëm në administrimin e punëve të përditshme të shkollave, por ai që përqendrohet në promovimin dhe sigurimin e cilësisë së arsimit dhe mësimdhënies. Meqenëse performanca e mësimdhënësve bazohet pjesërisht në qëndrimin e drejtorit ndaj rolit të tij, drejtorëve të shkollave duhet t'u mundësohet që të vlerësojnë stafin e shkollës, të krijojnë frymën ekipore, të japin informata kthyes konstruktive, të japin udhëzime dhe të trajnojnë stafin mësimor. Puna e drejtorit të shkollës është e lidhur në mënyrë të pashmangshme me edukimin cilësor sidomos nëse drejtorët promovojnë qasjen e integruar të zhvillimit të shkollës duke synuar përfshirjen aktive të të gjithë akterëve në procesin edukativo- arsimor. Ne e kemi përmendur këtë disa herë në këtë modul. Në mënyrë që drejtorët e shkollave të kenë një pasqyrë më të qartë mbi qasjen e përdorur nga udhëheqësit dhe drejtuesit efektiv për të siguruar arsim cilësor në institucionet e tyre, ne ju paraqesim diagramin e mëposhtëm. Nuk është e mjaftueshme të thuhet se një mënyrë e udhëheqjes cilësore dhe arsimit cilësor u paraqit në këtë diagram. Në të kundërtën, ne duhet të përmendim udhëheqjen cilësore të plotë, kështu që funksionimi i këtij diagrami në arsim varet nga tre faktorë kryesor: i) besimi, ii) menaxhimi dhe udhëheqja, dhe iii) fuqizimi.



8.2. Standardet për menaxhim dhe udhëheqje në shkolla

Në mënyrë që të pasurohet dhe ndryshohet korniza ligjore në Kosovë, MASH-i ka përgatitur dokumentin Standardet e menaxhimit dhe udhëheqjes efektive dhe cilësore në Kosovë. Ky dokument është përdorur si material bazë për *Udhëzimin Administrativ nr. 02/2012 për Standardet e Praktikës Profesionale për Drejtorët e Shkollave* dhe i cili do të shërbente si pikë fillestare e trajnimit profesional dhe avancimin e udhëheqësve arsimor në Kosovë. Por është e rëndësishme të mos shihet vetëm pjesa e menaxhimit. Një drejtor shkollë nuk është vetëm menaxher i gjërave teknike, por edhe një udhëheqës i qenieve njerëzore. Pra, udhëheqja është një faktor i rëndësishëm për çdo institucion arsimor.

Standardet e Praktikës Profesionale për drejtorët e shkollave në Kosovë

STANDARDI	PËRSHKRIMI
Udhëheqja dhe Motivimi	Drejtori i shkollës nxit suksesin e shkollës dhe të nxënësve duke lehtësuar zhvillimin, artikullimin dhe implementimin e një vizioni të të mësuarit i reflektuar në vlerat, misionin dhe objektivat e përbashkëta shkollore dhe mësimdhënie në klasë.
Mësimdhënia dhe mësimnxënia cilësore	Drejtori i shkollës siguron qasje të vazhdueshme në mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore për të gjithë nxënësit përmes implementimit të një kulture shkollore e cila vlerëson dhe mbështet mundësi të barabarta për të mësuarit e nxënësve dhe zhvillimin profesional të personelit.
Planifikimi dhe Menaxhimi	Drejtori i shkollës menaxhon shkollën, aktivitetet dhe burimet e shkollës për të siguruar një mjedis të sigurt, të shëndetshëm dhe efektiv të të mësuarit.
Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi	Drejtori i shkollës ndërton marrëdhënie të mira me komunitetin e shkollës (nxënësit, prindërit, personelin, këshillin e shkollës dhe palët tjera të interesit) dhe promovon udhëheqje të përbashkët në linjë me interesat e nxënësve të këtij komuniteti.
Legjislacioni dhe Shoqëria	Drejtori i shkollës i kupton dhe vepron me përgjegjësi ndaj konteksteve politike, sociale, ekonomike, ligjore dhe kulturore që ndikojnë në shkollë.
Etika Profesionale	Drejtori i shkollës vepron me drejtësi, integritet dhe etikë të lartë.

Standardet do të integrohen në secilin Modul të këtij programi me qëllim që të ofrojnë mundësi për pjesëmarrësit që të kuptojnë më mirë raportin ndërmjet planifikimit të zhvillimit të shkollës dhe praktikës së udhëheqjes së shkollës. Përmirësimi i performancës së drejtuesve të shkollave, sipas treguesve specifik të performancës të përcaktuara në UA për Standardet, është një tjetër fokus i përgjithshëm i këtij programi trajnues.

Pyetje për reflektim dhe diskutim:

1. Cili prej standardeve më lartë është më i rëndësishëm për pozitën e drejtorit të shkollës? Rivendosini, caktoni prioritete dhe shpjegoni arsyet prapa tyre?
2. Si do t'i vlerësonit kapacitetet e juaja për t'i plotësuar standardet?
3. Në cilën sferë nevojitet më shumë mbështetje?

8.3. Mekanizmat e ri për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar të Kosovës

PSE NEVOJITET STRATEGJIA E SIGURIMIT TË CILËSISË?

Sigurimi i cilësisë është një nga aspektet e arsimit parauniversitar në Kosovë që kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Mekanizmat që kanë ekzistuar më parë, siç është Institucioni Qendror Pedagogjik i Kosovës, institucionet pedagogjike komunale dhe pedagogët në shkolla, u shfuqizuan në vitin 2000 me një vendim të UNMIK-ut, pa i zëvendësuar ato me mekanizma të reja dhe funksionale. Ndërkohë u krijuan institucione të tilla si Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe Inspektorati i Arsimit, por detyrat e tyre nuk u përqendruan në Sigurimin e Cilësisë.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Ligji për Arsimin në Komuna solli risitë në fushën e Sigurimit të Cilësisë, duke deleguar disa përgjegjësi në këtë fushë nga niveli qendror në atë lokal. Megjithatë, miratimi i këtij ligji i ka gjetur komunat të papërgatitur me personel, por edhe me aspekte logjistike për t'u marrë me sfidat, si zbatimi i një sistemi të sigurimit të cilësisë në nivel vendi. Në dhjetor të vitit 2015, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar të Kosovës 2016-2020, e cila u zhvillua nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

CILI ËSHTË QËLLIMI DHE CILAT JANË OBJEKTIVAT STRATEGJIKE?

Ky dokument ka për qëllim prezantimin e mekanizmave të reja për Sistemin e Sigurimit të Cilësisë në nën-sektorin e Arsimit Parauniversitar të Kosovës.

Sigurimi i arsimit cilësor në nivelin parauniversitar është e vetmja mënyrë për të rritur gjasat e nxënësve për arsimim të mëtijshëm dhe punësim më të mirë. Cilësia në arsim është një çështje komplekse dhe është e lidhur si me qeverisjen ashtu edhe me udhëheqjen, si dhe me infrastrukturën, arsimin dhe aftësimin e mësimdhënësve, cilësinë e kurrikulave dhe teksteve shkollore ndër të tjera.

Prandaj, sigurimi i cilësisë është një punë po aq komplekse, gjë që kërkon masa të shumfishta paralele për të trajtuar një sërë aspektesh të lidhura me cilësinë.

Qëllimi i kësaj strategjie është të paraqitet një sistem gjithëpërfshirës i sigurimit të cilësisë në nën-sektorin e arsimit parauniversitar të Kosovës, me qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe rezultatet e arsimit.

Strategjia ka katër komponentë të ndryshëm të përfaqësuar nga katër objektiva strategjike dhe masa të ndërlidhura.

- OBJEKTIVI 1** Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë
- OBJEKTIVI 2** Avancimi i planifikimit të zhvillimit në nivel shkollor dhe komunal
- OBJEKTIVI 3** Ndërtimi i kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet
- OBJEKTIVI 4** Rritja e ndërgjegjësimit të palëve të interesuara për sigurimin e cilësisë

CILI ËSHTË MEKANIZMI I RI PËR SIGURIMIN E CILËSISË NË SHKOLLË?

Mekanizmi i ri i sigurimit të cilësisë në shkollë shkurtimisht prezantohet në skicën e mëposhtme.



Kjo Strategji e Sigurimit të Cilësisë ka katër komponentë të ndryshëm, të përfaqësuar përmes një sërë objektivash strategjike¹⁷ të paraqitura në dokument - Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar të Kosovës 2016-2020. Secili komponent përfshin një grup treguesish të përcaktuar për secilin objektiv strategjik që synon të arrihet deri në vitin 2020. Treguesit ndahen në dy periudha: periudha afatshkurtër 2016-2017 dhe periudha afatmesme 2018-2020. Secili tregues është rezultat i zbatimit të një sërë aktiviteteve që lidhen me objektivat specifike.

Një udhërrëfyes i detajuar është paraqitur në dokumentin e QAS dhe është në dispozicion në versionin e shtypur në zyrat e MASH-it dhe DKA-ve, si dhe në faqen e internetit të MASH-it www.MASH-gov.net

¹⁷ Shih Shtojcën: Objektivat strategjike të sigurimit të cilësisë

Për të siguruar zbatimin praktik të Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë, MASH-i ka hartuar një Udhëzim Administrativ (UA), duke përcaktuar kështu mekanizmin dhe procedurat për sigurimin e cilësisë, personelin përgjegjës dhe detyrat përkatëse, ngarkesën e punës, procedurat e planifikimit dhe raportimit që ndërlidhen me aktivitetet e sigurimit të cilësisë në nënsektorin e arsimit parauniversitar. UA i miratuar mund të gjendet në faqen e internetit të MASH-it www.mash-gov.net.

Këtij procesi do t'i kontribuonte angazhimi i nëpunësve të shërbimit profesional në të gjitha institucionet edukativo-arsimore, duke përfshirë: pedagogun, psikologun, punëtorin social etj.

9. Përmbyllja e Modullit

Qëllimi i këtij moduli ishte t'u sigurojë pjesëmarrësve të trajnimit njohuri të përgjithshme të aspekteve kyçe arsimore me ndikim të drejtpërdrejtë për një shkollë më të mirë, një shkollë e cila do të sigurojë një arsim cilësor për të gjithë nxënësit pavarësisht nga gjinia e tyre, gjendja fizike, përkatësia etnike ose statusi social. Roli kryesor i drejtorit të shkollës në përmbushjen e këtyre pritjeve u prezantua dhe u diskutua përmes temave dhe aktiviteteve të ndryshme gjatë këtij moduli. Janë planifikuar aktivitete të shumta dhe shumë prej tyre janë provuar gjatë këtij moduli të trajnimit. Ne ju inkurajojmë që të vazhdoni të mësoni dhe të diskutoni mbi temën e arsimit cilësor duke provuar pjesën tjetër të aktiviteteve dhe detyrave dhe duke identifikuar ato të reja gjatë praktikës tuaj. Këto disa ditë trajnim kanë për qëllim të kontribuojnë në procesin tuaj të vazhdueshëm të zhvillimit profesional si udhëheqës të shkollave - si katalizator për ndryshimin e shkollave.

✓ FJALORTHI

VLERËSIMI - është proces i nxjerrjes së kuptimit të asaj që vëzhgohet apo të bërjes së dukshme përmes matjes së performancës (p.sh. mësimi i nxënësve, cilësia e shkollës, etj).

ARRITJA - norma e përmbushjes së objektivave të caktuara, për shembull, objektivat e shkollës, objektivat e projektit, objektivat e programeve të trajnimit, objektivat e njësive mësimore etj.

KOMPETENCA - një kombinim dinamik i aftësive njohëse dhe meta-njohëse, njohurive dhe të kuptuarit, aftësitë ndërpersonale, intelektuale dhe praktike dhe vlerat etike.

EFEKTIVITETI - arritja e rezultatit/eve të dëshiruar.

EFIKASITETI - arritja e një rezultati të synuar duke përdorur sa më pak burime të mundshme (d.m.th. para, materiale, kohë, ekspertizë etj).

VLERËSIMI PASUES - është një vlerësim i cilësisë ose i vlerës së rezultateve të arritura lidhur me një rezultat apo proces të caktuar; p.sh. matja e kompetencave të nxënësve, ose vlerësimi i cilësisë së një procesi si mësimdhënia.

INSTRUMENTI I VLERËSIMIT - proces i përcaktuar i zhvilluar për të matur, vlerësuar dhe gjykuar cilësinë e një rezultati të arritur ose të dëshiruar.

TREGUESIT - Veprime të dukshme, sjellje ose prova të tjera që tregojnë praninë, gjendjen ose kushtet që lidhen me standardet. Treguesit mund të përdoren për vlerësimin e zhvillimit drejt arritjes së standardeve.

MONITORIMI - është një proces i krahasimit të vazhdueshëm të rezultateve të parashikuara me rezultatet aktuale

- Procedurat e rregullta sistematike për mbledhjen e informatave për aspekte të ndryshme arsimore. Qëllimi i monitorimit është të sigurojë efikasitetin dhe efektivitetin e punës në shkollë.

KONTROLLI I CILËSISË - mekanizmat dhe procedurat e veçanta të përdorura për të siguruar që proceset e zbatuara për arritjen e rezultateve të dëshiruara përdoren në mënyrë efektive.

TREGUESIT E CILËSISË - Diçka që tregon se si është gjendja në lidhje me një cilësi ose rezultat të dëshiruar.

MBIKËQYRJA - Procesi që u ofron palëve të interesuara në të gjitha nivelet me vazhdimësi informatat mbi zhvillimet.

STANDARDET – janë deklaratë e objektivave që përcaktojnë cilësinë e performancës; grup deklaratash që përcaktojnë atë që individët duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë në kryerjen e roleve të tyre; grup deklaratash që identifikon se cilat nivele arritjesh priten dhe janë të arritshme.

VETËVLERËSIMI - është një proces gjatë së cilit një institucion, agjenci, program ose individ mbledh informata për veten dhe gjyon cilësinë dhe vlerën e performancës.

VËZHGIMI - është proces i vëzhgimit të individëve që bëjnë një aktivitet të caktuar, ose gjatë ngjarjeve dhe situatave të ndryshme në mjedise dhe shkolla të ndryshme.

Referencat

- Republika e Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës: <http://ëëë.assembly-kosova.org/?cid=2,100,48>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Republika e Kosovës, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016: <http://www.MASH-gov.net/advCms/#id=62>
- Kombet e Bashkuara, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut: <http://www.un.org/en/documents/udhr/>
- Kombet e Bashkuara, Konventa e të Drejtave të Fëmijëve: <http://ëëë.ohchr.org/english/laë/crc.htm>
- Kombet e Bashkuara, Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit: <http://www.un.org/millennium-goals/>
- Banka Botërore, Edukimi për të gjithë (EPGJ): <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/TOPICS/EXTEDUCATION/0,,contentMDK:20374062~menuPK:540090~pagePK:148956~piPK:216618~theSitePK:282386,00.html>
- Komisioni Evropian, Traktati i Lisbonës: http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-policy/doc30_de.htm
- Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Objektivat dhe Trajnimi i BE-së (Standardet e krahasimit 2010-2020), 2011: http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-policy/doc/report10/report_en.pdf
- Hanushek/Woelfmann, 2007, faqe.1
- Akin, M., Vlad, V., 2011, “Raporti ndërmjet arsimit dhe investimeve të huaja të drejtpërdrejta” në Zhurnal in Evropian të studimeve ekonomike dhe politike / ejeps-4(1).2011
- Bashkimi Evropian, Programi evropian për të mësuarit gjatë gjithë jetës: http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-programme/doc78_en.htm



Shtojcat

Shtojca 1: Deklarata e të Drejtave të Njeriut¹⁸

Më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nxori dhe shpalli Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, tekstin e plotë të së cilës po e botojmë në faqet që vijojnë. Mbas këtij akti historik, Asambleja ftoi të gjitha shtetet anëtare që ta shpallin tekstin e Deklaratës dhe të përpiqen që të përhapet, paraqitet, lexohet dhe të shpjegohet, sidomos në shkolla dhe institucione të tjera edukuese, në të gjitha vendet dhe shtetet pa marrë parasysh statusin e tyre politik.

Teksti zyrtar i Deklaratës mund të gjendet në gjashtë gjuhë zyrtare të Kombeve të Bashkuara: angleze, frënge, kineze, ruse, spanjolle dhe arabe.

DEKLARATA E PERGJITHSHME MBI TE DREJTAT E NJERIUT

HYRJE

Mbasi njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë;

Mbasi mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut ka çuar drejt akteve barbare, të cilat kanë ofenduar ndërgjegjen e njerëzimit, dhe mbasi krijimi i botës në të cilën njerëzit do të gëzojnë lirinë e fjalës, të besimit dhe lirinë nga frika e skamja është proklamuar si dëshira më e lartë e çdo njeriu;

Mbasi është e nevojshme që të drejtat e njeriut të mbrohen me dispozita juridike, kështu që njeriu të mos jetë i shtrënguar që në pikën e fundit t'i përvishet kryengritjes kundër tiranisë dhe shtypjes;

Mbasi është e nevojshme që të nxitet zhvillimi i marrëdhënieve miqësore midis kombeve;

Mbasi popujt e Kombeve të Bashkuara vërtetuan përsëri në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e personit të njeriut dhe barazinë midis burrave dhe grave dhe mbasi vendosën që të nxitin përparimin shoqëror dhe të përmirësojnë nivelin e jetës në liri të plotë;

Mbasi shtetet anëtare u detyruan që, në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara, të sigurojnë respektimin e përgjithshëm dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore;

Mbasi kuptimi i përbashkët i këtyre të drejtave dhe lirive është më i rëndësishëm për realizimin e plotë të këtij detyrimi;

¹⁸ Në këtë shtojcë po i paraqesim vetëm disa pjesë të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut. Dokumenti i plotë mund të gjendet këtu: <http://www.un.org/en/documents/udhr/>

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME shpall këtë DEKLARATË TË PËRGJITHSHME MBI TË DREJTAT E NJERIUT si ideal të përgjithshëm të cilin duhet ta arrijnë të gjithë popujt dhe të gjitha kombet, në mënyrë që çdo njeri dhe çdo organizëm shoqëror, duke pasur parasysh gjithmonë këtë Deklaratë, të përpiqet që, me anë të mësimin dhe edukimit, të ndihmonte në respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive dhe që, me anë të masave progresive kombëtare dhe ndërkombëtare, të sigurohej njohja dhe zbatimi i tyre i përgjithshëm dhe i vërtetë, si midis popujve të vetë shteteve anëtare, ashtu edhe midis popujve të atyre territoreve që janë nën administrimin e tyre.

NENI 1.

Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi.

NENI 2.

Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh për sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër. Asnjë dallim nuk do të bëhet në bazë të statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose vendit të cilit i përket çdo njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetëqeverisës ose që gjendet në çfarëdo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit.

NENI 26.

1. Gjithkush ka të drejtën e shkollimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në shkollat fillore dhe të ulëta. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional duhet të zgjerohet e arsimi i lartë duhet t'u bëhet i mundshëm të gjithëve në bazë të aftësisë.
2. Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai duhet të nxisë kuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.
3. Të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimit për fëmijët e tyre e kanë në radhë të parë prindërit.

NENI 27.

1. Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të bashkësisë, të gëzojë artet dhe të përfitojë nga përparimi shkencor dhe dobietë e tij.
1. Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai vetë.

Shtojca 2: Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

PJESA I

NENI 1

Në këtë Konventë, me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

NENI 8

1. Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.
2. Në qoftë se një fëmije i mohohen në mënyrë të paligjshme disa ose të gjithë elementet e identitetit të tij, Shtetet Palë i japin atij ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt.

NENI 13

1. Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përcjellë informacione dhe ide të çdo lloji, pa marrë parasysh kujfijtë, në formë gojore, të shkruar, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur nga fëmija.
2. Ushtrimi i kësaj të drejte mund t'i nënshtrohet disa kufizimeve, por vetëm kur përcaktohen me ligj dhe janë të domosdoshme për:
 - (a) Respektimin e të drejtave ose reputacionit të të tjerëve; ose
 - (b) Mbrojtjen e sigurimit kombëtar, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

NENI 23

1. Shtetet Palë pranojnë se fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë.
2. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës me paaftësi për kujdes të posaçëm dhe nxisin e sigurojnë, brenda mundësive të të ardhurave të disponueshme, dhënien fëmijës, i cili përmbush kushtet, si dhe atyre që kujdesen për të, të ndihmës që kërkohet dhe që i përshtatet gjendjes së fëmijës dhe gjendjes financiare të prindërve të tij, ose të atyre që kujdesen për të.
3. Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijës me paaftësi, ndihma e dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni jepet falas sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindërve të tij ose të atyre që kujdesen për të dhe kjo synon që fëmijët me paaftësi të kenë mundësi efektive për marrin arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që fëmija të sigurojë një integrim shoqëror dhe zhvillim vetiak sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tij kulturor dhe shpirtëror.

4. Shtetet Palë, në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, nxisin shkëmbimin e informacionit të përshtatshëm në fushën e kujdesit shëndetësor parandalues dhe të trajtimit mjekësor, psikologjik dhe funksional të fëmijëve me paaftësi, përfshirë përhapjen dhe mundësinë e marrjes së informacionit lidhur me metodat e riaftësimit, edukimit dhe shërbimeve të formimit profesional, me qëllim që Shtetet Palë të kenë mundësi të përmirësojnë cilësitë dhe aftësitë e tyre dhe të zgjerojnë përvojën e tyre në këto fusha. Në këtë drejtim, duhet të mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

NENI 28

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:
- Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;
 - Inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm si të përgjithshëm, dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë;
 - U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme;
 - Bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor e profesional;
 - Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.
2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.
3. Shtetet Palë nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit, për të kontribuar, në mënyrë të veçantë, në zhdukjen e padijes dhe të analfabetizmit kudo në botë dhe për të lehtësuar përvetësimin e njohurive shkencore e teknike dhe të metodave moderne të mësimdhënies. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

NENI 29

1. Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:
- Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;
 - Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara;
 - Të rrisë respektin për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij, gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti;
 - Ta përgatisë fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymë e mirëkuptimit, paqes, tolerimit, barazisë midis sekseve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone;
 - Ta zhvillojë fëmijës respektin për mjedisin natyror.

2. Asnjë dispozitë e këtij neni ose e nenit 28 nuk do të interpretohet në mënyrë të atillë që të cënojë lirinë e personave fizikë ose juridikë, për të krijuar e drejtuar qendra arsimore, gjithmonë me kusht që parimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni të respektohen dhe që arsimi që jepet në këto qendra të jetë në përputhje me normat minimale që përcaktohen nga Shteti.

NENI 30

Në Shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare apo gjuhësore, ose persona me origjinë autoktone, një fëmije që i përket një minoriteti ose është autokton, nuk mund t'i mohohet e drejta për të pasur kulturën e vet, të ushtrijë dhe praktikojë fenë e vet, ose të përdorë gjuhën e vet së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tij.

NENI 31

1. Shtetet Palë i njohin fëmijës të drejtën të pushojë dhe argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse, në përshtatje me moshën, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.
2. Shtetet Palë respektojnë dhe nxisin të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje të plotë në jetën kulturore dhe artistike, inkurajojnë sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kohën e lirë dhe për veprimtari kulturore, artistike, argëtuese dhe çlodhëse.

Shtojca 3: Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm¹⁹

- OBJEKTIVI 1** Çrrënjësja e varfërisë në të gjitha format e saj kudo
- OBJEKTIVI 2** Çrrënjësja e urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe ushqimit të përmirësuar dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme
- OBJEKTIVI 3** Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në çdo moshë
- OBJEKTIVI 4** Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive për të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë
- OBJEKTIVI 5** Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave
- OBJEKTIVI 6** Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe higjienës publike për të gjithë
- OBJEKTIVI 7** Sigurimi i qasjes në energji të përballeshme financiarisht, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë
- OBJEKTIVI 8** Promovimi i rritjes ekonomike të përballeshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimi i plotë dhe produktiv dhe puna e denjë për të gjithë
- OBJEKTIVI 9** Ndërtimi i infrastrukturës elastike, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit
- OBJEKTIVI 10** Zvogëlimi i pabarazisë brenda dhe mes vendeve
- OBJEKTIVI 11** Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike dhe me zhvillim të qëndrueshëm
- OBJEKTIVI 12** Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit
- OBJEKTIVI 13** Ndërmarrja e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e saj
- OBJEKTIVI 14** Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillim të qëndrueshëm
- OBJEKTIVI 15** Mbrojtja, restaurimi dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, luftimi i shkretërimit të pyjeve dhe ndalimi i përmbysjes dhe degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit
- OBJEKTIVI 16** Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet
- OBJEKTIVI 17** Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i Partneritetit Global për Zhvillim të Qëndrueshëm

¹⁹ Rezoluta e plotë e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 25 shtator 2015 mund të gjendet në linkun vijues: http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E

Shtojca 4: Traktati i Lisbonës

Traktati i Lisbonës, që është në fuqi që nga 1 dhjetori 2009, nuk ka ndryshuar dispozitat sa i përket rolit të BE-së në edukim dhe aftësim:

NENI 6

“Unioni do të ketë kompetencë që të kryej veprime për të mbështetur, koordinuar apo plotësuar veprimet e Shteteve Anëtare. Fushat e veprimit të tillë, në nivel evropian, do të jenë: ... (e), arsimimi, trajnimi profesional, rinia dhe sportet.”

NENI 165 (ISH NENI 149 TEC):

1. Unioni do të kontribuojë në **zhvillimin e edukimit cilësor** duke inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe nëse është e nevojshme, duke përkrahur dhe plotësuar veprimin e tyre, duke respektuar plotësisht përgjegjësinë e Shteteve Anëtare për përmbajtjen e mësimdhënies dhe organizimin e sistemeve të arsimit dhe larminë e tyre kulturore dhe gjuhësore.

Unioni do të kontribuojë në promovimin e çështjeve evropiane sportive, duke marrë parasysh natyrën specifike të sportit, strukturat e saj, bazuar në aktivitetin vullnetar dhe funksionin e tij social dhe arsimor.

2. Veprimi i unionit do të synojë:

- zhvillimin e **dimensionit evropian në arsim**, veçanërisht përmes mësimdhënies dhe përhapjen e gjuhëve të Shteteve Anëtare,
- **inkurajimin e lëvizshmërisë së nxënësve dhe mësimdhënësve**, duke inkurajuar për të tjera, pranimin akademik të diplomave dhe periudhave të studimit,
- promovimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore,
- zhvillimin e shkëmbimit të informatave dhe përvojave për çështjet që janë të përbashkëta për sistemin arsimor të Shteteve Anëtare,
- inkurajimin e zhvillimit të shkëmbimit të të rinjve dhe shkëmbimit të instruktorëve socio-edukativ, dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën demokratike në Evropë,
- inkurajimin e zhvillimit të arsimit në distancë,
- zhvillimin e dimensionit evropian në sport, duke promovuar korrektësinë dhe transparencën në garat sportive dhe bashkëpunimin ndërmjet organeve përgjegjëse për sportin, dhe përmes mbrojtjes së integritetit fizik dhe moral të sportistëve dhe sportisteve, posaçërisht sportistëve dhe sportisteve në moshë më të re.

3. Unioni dhe Shtetet Anëtare do të nxisin bashkëpunimin me vendet e treta dhe organizatat kompetente ndërkombëtare në fushën e arsimit dhe sportit, në veçanti me Këshillin e Evropës

4. Në mënyrë që të kontribuojnë në arritjen e objektivave të referuara në këtë nen:

- Parlamenti dhe Këshilli Evropian, duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legislative, pas konsultimit me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, do të miratojnë masa nxitëse, duke përfshirë çdo harmonizim të ligjeve dhe rregulloreve të Shteteve Anëtare,
- Këshilli, me propozim të Komisionit, do t'i miratojë rekomandimet.

NENI 166 (ISH NENI 150 TEC)

1. Unioni do të zbatojë një **politikë të trajnimit profesional** që do të përkrahë dhe plotësojë veprimin e Shteteve Anëtare, duke respektuar në ndërkohë plotësisht përgjegjësinë e Shteteve Anëtare për përmbajtjen dhe organizimin e trajnimit profesional.
2. Veprimi i Unionit do të synojë drejtë:
 - lehtësimit të përshtatjes me ndryshimet industriale, në veçanti nëpërmjet trajnimit dhe ri-trajnimit profesional,
 - përmirësimit të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm profesional për të lehtësuar integrimin profesional dhe riintegrimin në tregun e punës,
 - lehtësimit të qasjes në aftësimin profesional dhe inkurajimit të lëvizjes së instruktorëve dhe të trajnuarve dhe veçanërisht të të rinjve,
 - stimulimit të bashkëpunimit për trajnim në mes të institucioneve arsimore dhe të trajnimit si dhe të firmave,
 - zhvillimit të shkëmbimit të informatave dhe përvojës në çështje të përbashkëta me sistemet e trajnimit të Shteteve Anëtare.
3. Unioni dhe Shtetet Anëtare do të nxisin bashkëpunimin me vendet e treta dhe organizatat kompetente ndërkombëtare në sferën e trajnimit profesional.
4. Parlamenti dhe Këshilli Evropian, duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legislative dhe pas konsultimit me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, do të miratojnë masa për të kontribuar në arritjen e objektivave të përmendura në këtë nen, duke përfshirë çdo harmonizim të ligjeve dhe rregulloreve të Shteteve Anëtare, dhe Këshilli me propozim të Komisionit, do t'i miratojë rekomandimet.

Shtojca 5: Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës

NENI 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga nivelet ISCED 0 deri në 4, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin për fëmijët dhe të rriturit që marrin kualifikime në këto nivele.
2. Qëllimet e arsimimit dhe aftësimimit parauniversitar janë:
 - 2.1. zhvillimi i personalitetit, talentit dhe aftësisë mendore e fizike të nxënësit deri në potencialin e tij të plotë;
 - 2.2. avancimi i krijimit të njohurive themelore shkencore, shkathtësive të komunikimit, vrojtimit dhe shkathtësive analitike, kreativitetit, mëvetësisë dhe aftësive të ndërlidhura të mësimnxënies;
 - 2.3. zhvillimi i respektit të nxënësi për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe për parimet e përcaktuara me Kartën e Kombeve të Bashkuara, me konventat përkatëse dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
 - 2.4. zhvillimi i respektit të nxënësit për prindërit dhe mësimdhënësit, për identitetin kulturor, gjuhën dhe vlerat e komunitetit të tij, për vlerat e Republikës së Kosovës, për shtetin nga i cili mund të ketë prejardhjen dhe për respektimin e diversitetit;
 - 2.5. përgatitja e nxënësit për jetesë të përgjegjshme në frymën e mirëkuptimit, të paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe në miqësi me pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës;
 - 2.6. të zhvillojë të nxënësi respektin për mjedisin.
3. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk do të interpretohet si zvogëlim apo kufizim i çfarëdo të drejte të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, të paraparë me ligjin në fuqi.

NENI 3

Parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar

1. Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim.
2. Arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj.
3. Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.
4. Gjatë planifikimit, menaxhimit dhe zbatimit të sistemit të arsimit parauniversitar, Ministria, komunat, si dhe institucionet arsimore dhe ato aftësuese do të marrin parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në shoqëri dhe për avancimin e barazisë gjinore.

5. Gjatë zbatimit të funksioneve dhe përgjegjësi të tyre në kuadër të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, Ministria, komunat dhe institucionet arsimore apo ato aftësuese do të:
 - 5.1. respektojnë dhe avancojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, siç parashihet me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi;
 - 5.2. kultivojnë njohuritë për kulturën, historinë, dhe gjuhën e të gjitha komuniteteve.
6. Qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin parauniversitar do të mundësohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji pa diskriminim në baza ekzistuese ose të supozuara, siç është ai: gjinor, racor, i orientimit seksual, i paaftësitë fizike, intelektuale ose i çfarëdo paaftësie tjetër, i gjendjes martesore, i ngjyrës, i fesë, i opinionëve politike apo të tjera, i përkatësisë kombëtare, etnike ose shoqërore, i shoqërimit me ndonjë komunitet, i pronës, i lindjes ose i ndonjë gjendje tjetër të nxënësit apo familjes së tij.
7. Institucionet publike arsimore duhet të përmbahen nga mësimdhënia fetare ose veprimtaritë tjera, të cilat propagandojnë një fe të caktuar.
8. Ministria, komuna, institucionet arsimore dhe aftësuese dhe komuniteti duhet ta bëjnë institucionin tërheqës dhe të sigurt për nxënësin, mësimdhënësin dhe prindërit, përmes përgjegjësi të tyre përkatëse për kurrikulum, standardet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave shkollore, shëndetësisë dhe sigurisë, ruajtjes së ambientit si dhe adresimit të çështjeve disiplinore dhe sjelljeve.

NENI 4

Mbrojtja e grupeve të cenueshme

1. Të gjithë personat e punësuar në institucione arsimore, të themeluara sipas këtij ligji, do të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm që të sigurojnë se nxënësit dhe punonjësit nuk lëndohen apo u ekspozohen fjalëve dhe veprimeve fyese.
2. Ndalohet ndëshkimi fizik apo çfarëdo forme tjetër e ndëshkimit nënçmues në të gjitha institucionet arsimore dhe aftësuese, qofshin ato publike ose private.
3. Ndalohen aktivitetet promovuese jashtë Kornizës së Kurrikulimit të Kosovës në përfitim ose në dëm të çfarëdo partie politike, gjinie, përkatësie racore a etnike, feje ose pozite sociale nëpër institucionet arsimore dhe aftësuese. Kur çështjet relevante paraqiten para nxënësve gjatë procesit mësimor, nxënësve duhet t'u ofrohet prezantim i balancuar i pikëpamjeve të kundërta.

NENI 8

Inspektimi i arsimit

- 8.0. Qëllimet e inspektimit të funksionimit të institucionit arsimor dhe aftësues në nivelin 0,1,2,3 dhe 4 të ISCED-it janë që së bashku me inspektorë të fushave të tjera (punësimi, shëndetësia, ndërtimi, financat etj) të kontrollojnë dhe evidentojnë:
 - 8.1. respektimin e detyrave dhe funksioneve përkatëse të institucionit në përputhje me këtë ligj si dhe ligjet tjera dhe aktet nënligjore;
 - 8.2. funksionimin e këshillit drejtues të institucionit, funksionimin e këshillit të prindërve dhe këshillit të nxënësve, korrektësinë në të dhënat e nxënësve sipas niveleve dhe klasave, saktësinë në dokumentet pedagogjike dhe shkollore, organizimin e mësimin;

- 8.3. numrin, kualifikimet dhe mundësitë për zhvillim profesional të mësimeve;
- 8.4. ambientin e punës duke përfshirë respektimin e standardeve të shëndetësisë dhe sigurisë, të dhënat e evidentuara të veprimeve disiplinore dhe rezultatet e tyre;
- 8.5. zbatimin e Kornizës Kombëtare të Kurrikulimit duke përfshirë kurrikulumin bërthamë, kurrikulumin me bazë shkolle, procedurat e testimit dhe vlerësimit, përdorimin e teksteve të miratuara dhe materialet mësimore;
- 8.6. dhe, në rastet kur evidentohet moszbatim i aspekteve të mësipërme, drejtorit të institucionit në fjalë i jepen rekomandime dhe këshilla specifike për ndryshimet e nevojshme në një afat të caktuar.
- 9.0. Departamenti i Inspektimit gjithashtu ka përgjegjësinë të monitorojë dhe vlerësojë punën akademike të institucionit si pjesë e ciklit vjetor të inspektimit. Ministria, në konsultim me Agjencionin e Kosovës për Kurrikul Standarde dhe Vlerësim përcakton kritere dhe procedura për inspektim kombëtar që mund të përfshijë ekspertë në disa fusha specifike akademike ose profesionale në përputhje me paragrafin 4. të nenit 25 të këtij ligji.

NENI 16

Këshilli i Prindërve të Kosovës

1. Ministria themelon Këshillin e Prindërve të Kosovës (KPK). Ky Këshill ka nëntë (9) anëtarë. Kohëzgjatja e mandatit të tyre është katër (4) vite dhe anëtarët zgjedhin kryesuesin dhe nënkryesuesin e Këshillit.
2. Funkcioni i KPK-së është përfaqësimi i interesave të prindërve, inkurajim dhe avancim i rolit të prindërve si palë e rëndësishme e interesit në promovimin e cilësisë në arsim, përcjellja e mendimeve të prindërve te Ministria lidhur me çfarëdo aspekti të arsimit parauniversitar dhe të jetë kanali kryesor i komunikimit dhe këshillimit mes Ministrisë, institucioneve arsimore e aftësuese dhe prindërve.
3. Ministria nxjerr akt nënligjor për punën e KPK-së, procedurat për emërimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të tij, duke përfshirë gjithmonë anëtarë të komuniteteve jo shumicë.
4. Ministria siguron buxhetin vjetor dhe infrastrukturën logjistike që të mundësojë punën efektive të KPK-së.

PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE ARSIMORE

NENI 17

Këshilli drejtues

1. Çdo institucion publik arsimor dhe aftësues duhet të ketë këshillin drejtues. Në rast se këshilli drejtues nuk mund të formohet ose nuk mund të mblidhet në periudhën prej tre (3) muajsh, funksionet e tij merren nga drejtori i institucionit, me kusht që komuna (Ministria në rastet e institucioneve të nivelit 4 të ISCED-it) vazhdon me përpjekjet e mëtutjeshme për ta themeluar këtë këshill dhe për të mbajtur takimet e tij çdo tre (3) muaj.
11. Këshilli drejtues i shkollës në nivelet 1,2 dhe 3 të ISCED-së, ka detyrat dhe kompetencat si vijon:
 - 11.1. të hartojë rregullat e shkollës të specifikuara në nenin 22 të këtij ligji, për t'u miratuar nga komuna;
 - 11.2. të zgjedhë një përfaqësues të prindërve dhe një të mësimdhënësve nga anëtarët e Këshillit Drejtues, që të marrin pjesë në cilësinë e vëzhguesve në emërimin e drejtorit, zëvendës drejtorit dhe mësimdhënësve të shkollës;
 - 11.3. të ushtrojë funksionet e ndërlidhura me shfrytëzimin e buxhetit të shkollës, përfshirë edhe skemën e delegimit mes komunës, organit drejtues të shkollës dhe drejtorit të shkollës, siç është përcaktuar në këtë ligj.
 - 11.4. të vendosë për shfrytëzimin e fondeve që i janë dhënë shkollës si kontribut nga prindërit ose donatorët e tjerë;
 - 11.5. të miratojë aktivitetet jashtë kurrikulare të shkollës, sipas propozimit të drejtorit të shkollës;
 - 11.6. të vendosë për kodin e veshjes së punonjësve dhe nxënësve;
 - 11.7. të shpreh pikëpamjet e veta për çështjet që kanë të bëjnë me shkollën apo çfarëdo aspekti të arsimit parauniversitar;
 - 11.8. të miratojë listën e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera shkollore për t'u përdorë në shkollë në bazë të propozimeve të mësimdhënësve të shkollës, brenda kufizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
 - 11.9. të kontribuojë në hartimin e planit zhvillimor të arsimit nga komuna në rastet, kur ka të bëjë me shkollën përkatëse;
 - 11.10. të ushtrojë funksionet e tjera që i janë deleguar nga komuna në pajtim me ligjin;

NENI 18

Këshilli i nxënësve

1. Këshilli drejtues i çdo shkolle të nivelit 2 dhe 3 të ISCED-it themelon një këshill të nxënësve, i cili duhet të ketë së paku një nxënës të zgjedhur nga secila klasë dhe që zgjidhet çdo vit përmes votës së fshehtë.
2. Roli i Këshillit të nxënësve është të punojë në përmirësimin e mjedisit mësimor, kushteve të punës dhe interesave që kanë të bëjnë me shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve si dhe të përfaqësohen në këshillin drejtues.

NENI 19**Këshilli i prindërve**

1. Çdo institucion arsimor apo aftësues duhet të ketë këshill të prindërve.
2. Kompetencat dhe fushë veprimtaria e Këshillit të prindërve përcaktohen përmes aktit të veçantë nënligjor.
3. Këshilli i prindërve zgjidhet me vota të fshehta të gjithë prindërve të nxënësve që vijojnë mësimin në atë institucion.
4. Prindërit, përveç përfaqësimit në Këshillin e Prindërve, kanë të drejtë t'i paraqesin ankesat e tyre, drejtorit të institucionit arsimor dhe aftësues, komunës dhe Ministrisë lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe mjedisin shkollor.

KURRIKULUMI, TEKSTET SHKOLLORE, MJETET MËSIMORE DHE STANDARDET

NENI 24**Korniza e Kurrikulumit e Kosovës**

5. Ministria, AKKSV, komuna, Këshilli drejtues dhe drejtori i një institucioni arsimor dhe aftësues ushtrojnë funksionet e tyre përkatëse sipas këtij ligji me qëllim që të sigurojnë se Korniza e Kurrikulumit të Kosovës, i përmbahet parimeve në vijim: edukimi dhe arsimimi cilësor për të gjithë, gjithë përfshirja, qasja e bazuar në kompetenca, fleksibiliteti dhe lëvizshmëria, transparenca dhe llogaridhënia dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, si dhe:
 - 5.1. promovon zhvillimin intelektual, moral, kulturor dhe fizik të nxënësve dhe të shoqërisë;
 - 5.2. përgatit nxënësit për mundësitë dhe përgjegjësitë për jetë dhe punë të suksesshme;
 - 5.3. përcakton njohuritë, shkathtësitë dhe vlerat sipas nivelit të arsimit të shprehura në kompetenca;
 - 5.4. promovon frymën e respektit, mirëkuptimit dhe tolerancës mes të gjitha komuniteteve.
8. KKK u mundëson të gjithë nxënësve të zgjerojnë njohuritë rreth identitetit, Kulturës dhe gjuhës së tyre, si dhe inkurajon dialogun ndërkulturor.

NENI 39**Nevojat e veçanta arsimore**

1. Fëmija ka vështirësi në mësim nëse:
 - 1.1. ka vështirësi dukshëm më të mëdha në mësim sesa shumica e fëmijëve të asaj moshe;
 - 1.2. ka një paaftësi e cila e ndalon ose e pengon atë nga përdorimi i pajisjeve arsimore të llojit që ofrohen në përgjithësi për fëmijët e moshës së tij në institucionet arsimore apo aftësuese.
2. Fëmija nuk duhet të konsiderohet se ka vështirësi në mësim vetëm për shkak se gjuha, ose forma e gjuhës, në të cilën zhvillohet mësimi nuk është e njëjtë me gjuhën, ose me formën e gjuhës, të cilën e përdor në shtëpi të tij ose sepse i takon një komuniteti të caktuar dhe në rastet e tilla komuna duhet të sigurojë që fëmijës t'i ofrohet mbështetje efikase në gjuhën e mësimdhënies.

3. Ofrimi i arsimit të posaçëm për fëmijët do të thotë ofrimi i arsimit që i shtohet ose dallon nga arsimit që në përgjithësi bëhet për fëmijët e moshës së tij në institucionet arsimore dhe aftësuese të themeluara në komunë.
4. Ofrimi i arsimit të posaçëm nuk kufizohet vetëm për fëmijët me vështirësi në mësim, por kjo gjithashtu zbatohet edhe për fëmijët me dhunti të veçanta, të cilët mund të kërkojnë modifikim të modeleve të zakonshme të progresit në sistemin e arsimit të detyruar, përfshirë edhe kurrikulumin.

NENI 40

Parimi i arsimit gjithëpërfshirës

1. Qëllimi i qartë i këtij Ligji është që parimi i arsimit gjithëpërfshirës të zbatohet në Republikën e Kosovës si praktika më e mirë në përputhje me normat ndërkombëtare, si parashihen në Konventën e UNESCO-s për të Drejtat e Fëmijëve (1989), në Deklaratën e Salamankës (1994), Konventën e OKB-së për të Drejta të Personave me Aftësi të Kufizuara (2007) dhe në konventat apo rekomandimet e tjera përkatëse ndërkombëtare.
2. Parimi i arsimit gjithëpërfshirës nënkupton se:
 - 2.1. institucionet arsimore dhe aftësuese duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe duhet të promovojë integrimin dhe kontaktin mes fëmijëve;
 - 2.2. mbështetja përkatëse duhet të ofrohet bazuar në nevojat intelektuale të nxënësve; dhe
 - 2.3. ambientet e posaçme arsimore apo shkollat speciale arsyetohen vetëm pasi që nga vlerësimi i ekspertit del se nuk është praktike të regjistrohet ndonjë fëmijë në shkollën e rregullt publike apo në institucionin e aftësimin.
3. Komunitet marrin masa për të mbështetur përfshirjen e fëmijëve në shkolla të rregullta të komunës, përfshirë edhe themelimin e dhomave burimore dhe klasave të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara fizike, përfshirë ato ndijore.
4. Sipas vlerësimeve individuale profesionale, komunitet sigurojnë transport falas, të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara apo me vështirësi në mësim që ndjekin mësimet në shkollë komunale.

NENI 41

Vlerësimi profesional

1. Çdo komunë duhet që vetë apo në bashkëpunim me komunitet e tjera të themelojë ekip profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore, të përbërë nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe të rehabilitimit, si mbështetje e jashtme për institucionet arsimore dhe aftësuese për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit.
2. Procedura e vlerësimit nga ekipi profesional mund të fillohet me kërkesën e ndonjë prindi apo institucioni arsimor a aftësues me pëlqimin e prindit.
3. Në përputhje me parimet e arsimit gjithëpërfshirës dhe duke pasur parasysh dëshirat dhe opinionet e prindërve, vlerësimi profesional shqyrton dhe përcakton nëse nxënësi ka nevojë për vijimin e shkollimit special dhe çfarë lloji i mësimdhënies duhet të ofrohet, ku qëllimet e vlerësimit janë si në vijim:

- 3.1. për të vlerësuar aftësitë, interesimet dhe nevojat e fëmijës;
 - 3.2. për të dhënë rekomandime mbi metodat e mësimdhënies, mjetet e mësimdhënies dhe mbi përshtatjet e tjera të nevojshme për mësimnxënie dhe mirëqenien e fëmijës;
 - 3.3. për të përkufizuar nevojat për pajisjet të posaçme që nevojiten në mësimdhënie;
 - 3.4. për të dhënë rekomandime për regjistrimin e nxënësit.
4. Ministria, me akt nënligjor, përcakton procedurat dhe afatet kohore për vlerësimin profesional.
 5. Nëse vendimi i komunës ndryshon nga vlerësimi profesional i ekspertëve, arsyet për vendimin e komunës duhet të shpjegohen me shkrim. Prindërve u jepet mundësia të bëjnë ankesë me shkrim. Në raste të tilla, Ministria do të sjellë vendimin përfundimtar dhe ajo mund të konsultohet me këta ekspertë siç përcakton vet.
 6. Përmbajtja e mësimdhënies për nxënësit me nevoja të veçanta për arsim përcaktohet në planet e arsimit individual. Procedura dhe modeli i këtyre planeve rregullohet me akt nënligjor.

Shtojca 6: Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021

3. Vizioni, Misioni dhe Vlerat tona

PSAK 2017-2021 merr si pikënisje legjislacionin e miratuar nga Qeveria e Kosovës, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, dhe dokumentacionin tjetër relevant. Në kuadër të këtyre parametrave dhe duke marrë parasysh mjedisin aktual vendor dhe ndërkombëtar, grupi i gjerë i akterëve të përfshirë në zhvillimin e PSAK-ut kanë formuluar një vizion të përditësuar për arsimin në Kosovë: Kosova, një shoqëri konkurruese e dijes, e bazuar në vlerat evropiane me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e saj për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Mandatet e institucioneve kryesore përgjegjëse për arsimin dhe aftësimin në Kosovë janë të rrënjosura në ligj ose udhëzime administrative. Megjithatë, të gjitha organizatat, përveç që duhet të veprojnë në përputhje me mandatin e tyre, janë relativisht të lira për të inicuar aktivitetet tjera për aq kohë sa nuk janë shprehimisht të ndaluara. Duhet shpresuar që të gjitha institucionet do të zhvillojnë plotësisht potencialin e tyre në mënyrë që të përmirësojnë cilësinë e ofrimit të arsimit në të gjitha nivelet në Kosovë. Deklarata e misionit e formuluar nga akterët gjatë zhvillimit të PSAK-ut ofron një mjet të dobishëm për të ndihmuar në inkurajimin e këtij kreativiteti: Zhvillimi i një sistemi arsimor të bazuar në cilësinë, gjithëpërfshirjen dhe llogaridhënien, duke ofruar arsim dhe trajnim të individëve në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Ne gjithashtu kemi marrë hapin e afirmimit të vlerave tona në mënyrë që të nënvizojmë qasjen tonë strategjike për t'u ballafaquar me rrethanat e ndryshimeve të shpejta në të cilat do të zbatohet PSAK-u, dhe për të mbështetur përmbushjen e objektivave tona. Vlerat janë në thelbin e kulturës dhe sjelljes tonë organizative. Ato identifikojnë atë që ne besojmë fuqishëm dhe ato bëjnë një deklaratë të fortë për besimet, qëndrimet dhe sjelljet që udhëzojnë se si do të ofrojmë shërbime cilësore arsimore dhe trajnuese për popullin e Kosovës. Ne jemi konsultuar gjerësisht për të siguruar që vlerat të ndahen me të tjerët.

VIZIONI:

Kosova, një shoqëri konkurruese e dijes, e bazuar në vlerat evropiane me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e saj për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social.

MISIONI:

Zhvillimi i një sistemi arsimor bazuar në cilësinë, gjithëpërfshirjen dhe llogaridhënien, duke ofruar arsim dhe trajnim të individëve në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

VLERAT:


- ✓ **RESPEKTI:** ne i afrohem i tjerëve në një mënyrë që tregon se i vlerësojmë ata dhe kontributin e tyre. Ne tregojmë respekt në të gjitha marrëdhëniet tona me akterët, duke përfshirë marrëdhëniet në mes të menaxhmentit dhe stafit, si dhe mënyrën se si komunikojmë me financuesit tanë dhe ofrojmë shërbime për klientët.
- ✓ **INTEGRITETI:** ne do të fitojmë besim dhe respekt duke qenë etik, të ndershëm dhe të paanshëm. Ne jemi të ndershëm dhe të sqartë në të gjitha marrëdhëniet dhe komunikimet tona. Ne sigurojmë informata me kohë, të përshtatshme dhe të ndershme.
- ✓ **GJITHËPËRFSHIRJA:** ne jemi të përkushtuar ndaj diversitetit, barazisë së mundësive dhe drejtësisë sociale, dhe ne e vlerësojmë dhe i gëzojmë dallimet. Ne ofrojmë shërbime kulturore gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.
- ✓ **BASHKËPUNIMI DHE PARTNERITETI:** ne e njohim partneritetin dhe bashkëpunimin si mënyra më efektive për të përmirësuar cilësinë e shërbimit tonë.
- ✓ **INOVACIONI:** ne jemi të hapur për ndryshime, përshtatje, veprim proaktiv dhe inovacione, ndërsa punojmë së bashku në shkollat dhe vendet tona të punës për të gjetur qasje të reja për të përmbushur sfidat në një mjedis gjithnjë në ndryshim.
- ✓ **PËRSOSMËRIA:** ne kemi pritshmëri të larta për veten, nxënësit dhe komunitetet tona dhe ne synojmë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit tonë.

4. Qasja jonë Strategjike

Ne kemi bërë përpjekje të mëdha për t'iu qasur zhvillimit të PSAK-ut 2017-2021 në një mënyrë sa më strategjike të mundshme, siç është identifikuar në udhëzimet e fundit përkatëse.

Mendim i konsiderueshëm i është dhënë asaj se cilat elemente kanë më shumë gjasa të lehtësojnë hartimin e PSAK-ut të ri, i cili mund të synojë përsosmërinë në hartimin dhe përmbajtjen e tij, dhe që do të kishte një ndikim të vërtetë në arsimin në Kosovë.

Komponentët kryesorë të qasjes sonë strategjike të zgjedhur janë ilustruar grafikisht në grafikun e mëposhtëm.



5. Prioritetet tona Strategjike

Prioritetet strategjike të PSAK-ut 2017-2021 janë kryesisht tematike, me vetëm dy referenca për nënsektorë të veçantë. Vendimi për të miratuar këtë qasje pasqyron çështjet e dyfishimit të identifikuara nga rishikimi i PSAK-ut 2011-2016, si dhe duke u ndërlidhur me prioritetet tematike të identifikuara tashmë nga Qeveria, dhe mbi të gjitha, dëshira për të siguruar që PSAK-u i ri të ketë një orientim të qartë strategjik. Të dyja përjashtimet, AAP/Arsimi i të Rriturve dhe Arsimi i Lartë, janë në mënyrë të pashmangshme më të gjera në kompetencat e tyre sesa nën-sektorët e MASH-it të fokusuar në shkolla. Shtatë Fushat Strategjike Prioritare janë identifikuar dhe shtjelluar.

Prioriteti Strategjik/PS 1: Pjesëmarrja dhe Gjithëpërfshirja

Rritja e pjesëmarrjes dhe ofrimi i mundësive të barabarta për zhvillimin, trajnimin dhe edukimin e çdo individi në arsimin parauniversitar

Ky prioritet strategjik lidhet drejtpërsëdrejti me prioritetet e Qeverisë, Kornizën Strategjike të BE-s 2020 dhe SE 2020, si dhe vlerësimin e fundit të PSAK-ut 2011-2016. Megjithatë, rritja e përfshirjes dhe parandalimi i braktisjes në arsim kërkon kohë dhe nuk mund të arrihet pa zbatimin e plotë të kornizës ligjore. Kjo është prandaj një çështje komplekse, e cila kërkon mobilizimin e shkollave, si dhe qeverisë lokale dhe qendrore. Ky prioritet strategjik ka lidhje të qarta me aspekte të tjera të PSAK-ut, veçanërisht në lidhje me krijimin e një sistemi të integruar për grumbullimin, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave që gjithashtu do të mundësojë monitorimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe fëmijëve që kanë braktisur shkollën, si dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies si përmes ofrimit të programeve të trajnimit për gjithëpërfshirje, ashtu edhe zbatimit të ideve dhe qëllimeve themelore të KKK-së.

Prioriteti Strategjik/PS 2: Menaxhimi i Sistemit Arsimor

Përmirësimi i cilësisë dhe menaxhimi efikas i sistemit arsimor, bazuar në transparencë dhe llogaridhënie

Ky prioritet strategjik rrjedh gjithashtu direkt nga SKZh-ja. Në rrethanat ku sistemi arsimor është i decentralizuar, përparimet në ofrimin e arsimit varen shumë, krahas disponueshmërisë së autonomisë së plotë financiare dhe profesionale, pra nga zhvillimi i kapacitetit menaxhues në nivel qendror, komunal dhe shkollor. Në kontekstin e decentralizimit, ndërtimi i kapaciteteve në nivelin lokal/shkollor duhet të shtrihet tek organet si këshillat drejtues të shkollave, të cilat duhet të luajnë një rol kyç në këtë proces. Ky prioritet pra mbështet të gjithë PSAK-un 2017-2021, dhe si me PS1, ai është i ndërlidhur ngushtë me aspekte të tjera të PSAK-ut, që duhet të jetë parimi udhëheqës i ngritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe zhvillimit të një sistemi të sigurimit të cilësisë.

Prioriteti Strategjik/PS 3: Sigurimi i Cilësisë

Zhvillimi i një sistemi funksional të sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare

Ky prioritet strategjik korrespondon me një element kyç të SKZh-së, dhe lidhet direkt me Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë. Ky element aktualisht mungon në masë të madhe nga sistemi arsimor në Kosovë, dhe do të jetë thelbësor për çdo progres të ardhshëm në cilësinë e ofrimit të arsimit. Përveç krijimit të një sistemi të menaxhimit të cilësisë dhe zhvillimit të proceseve dhe mjeteve përkatëse, ngritja e kapaciteteve në të gjitha nivelet do të jetë e nevojshme për të bërë çdo sistem të ri të sigurimit të cilësisë funksional. Për më tepër, në klimën e tanishme në Kosovë, do të nevojiten edhe aktivitete ndërgjegjësimi që krijojnë një mjedis ku përkrahet llogaridhënia. Megjithëse sistemi i sigurimit të cilësisë për arsimin e lartë, dhe deri në një masë të caktuar edhe për AAP-në, është i ndarë dhe i themeluar tashmë, ky prioritet strategjik është kryesisht i varur nga ndryshimet legjislative. Më pas, ai ndërlidhet drejtpërdrejtë me një marrëdhënie të dyanshme, me përmirësimin në menaxhimin e arsimit, dhe ka një funksion kyç në sigurimin e suksesit të prioriteteve të tjera strategjike.

Prioriteti Strategjik 4/ PS4: Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet një sistemi efektiv dhe të qëndrueshëm për zhvillimin dhe përgatitjen profesionale të mësimdhënësve

Rëndësia e këtij prioriteti strategjik është e qartë. Sipas hulumtimeve ndërkombëtare mbi ekonominë e arsimit, cilësia e mësimdhënësve është përcaktuesi kryesor i performancës së nxënësve. Fokusi kryesor në këtë fushë është pra ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, i cili do të kontribuonte në zbatimin e reformës shkollore dhe do të ndikonte direkt në përmirësimin e rezultateve të nxënësve. Sërish, ky prioritet strategjik lidhet me të gjitha prioritetet tjera në një gamë të gjerë mënyrash, nga sigurimi i programeve që u ndihmojnë mësimdhënësve të zbatojnë gjithëpërfshirjen e nxënësve në procesin mësimor, duke u kushtuar vëmendje shtesë nxënësve me nevoja të veçanta dhe atyre nga grupet e marginalizuara (PS 1), deri tek ofrimi i trajnimeve për zbatimin e KKK-së (PS5), dhe ndikimi në kualifikimin e mësimdhënësve para shërbimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë (PS7).

Prioriteti Strategjik 5/ PS5: Mësimnxënia dhe Mësimdhënia

Maksimizimi i të mësuarit përmes mësimdhënies cilësore, zbatimi i kurrikulave të bazuara në kompetenca dhe përdorimi i burimeve mësimore me cilësi të lartë

Zbatimi i kurrikulës së re në të gjitha shkollat shihet si punë qenësore në përmirësimin e cilësisë së mësimin në Kosovë. Përveç trajnimit të mësimdhënësve, kjo kërkon përgatitjen e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke përfshirë materialet mësimore elektronike që janë në harmoni me KKK-në. Kjo gjithashtu nënkupton që t'i kushtohet vëmendje e veçantë pajimit të shkollave me pajisjet e TIK-ut, si dhe me materialet e tjera mësimore. Prioriteti lidhet me PS1 në kuptimin e zhvillimit të qasjes dhe gjithëpërfshirjes; me PS 3, veçanërisht në lidhje me organizimin e punës së departamenteve të shkollave; dhe me PS4 në atë se zbatimi i suksesshëm i kurrikulit të ri varet shumë nga zhvillimi i mësimdhënësve.

Prioriteti Strategjik 6/PS6: AAP dhe Arsimi i të Rriturve

Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe jashtë vendit, dhe krijimi i një sistemi të hapur për arsimin e të rriturve

Ky prioritet lidhet direkt me një numër iniciativash kombëtare dhe ndërkombëtare, që rrjedhin në veçanti nga strategjia e BE-s 2020 dhe SE 2020. Në aspektin e AAP-së, fokusi do të jetë në përmirësimin e relevancës së programeve shkollore me nevojat e tregut të punës, zhvillimin e një kurrikule bërthamë specifike të AAP-së të harmonizuar me KKK-në, sigurimin sistematik të përvojës së punës dhe praktikës profesionale të cilësisë së lartë, dhe veçanërisht në kontekstin e Kosovës, sigurimi i qëndrueshmërisë së Qendrave të Kompetencës dhe zhvillimit të tyre të mëtejshëm. Në aspektin e arsimit të të rriturve, fokusi nuk duhet të jetë asgjë më pak se krijimi i një sistemi arsimor efektiv dhe cilësor. Ky prioritet strategjik ndërlidhet në veçanti me PS1, duke pasur parasysh se promovimi i barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirja duhet të vazhdohet në AAP dhe të plotësohet nga Mësimi gjatë Gjithë Jetës.

Prioriteti Strategjik 7/ PS7: Arsimi i Lartë

Përmirësimi i cilësisë dhe konkurrencës së arsimit të lartë përmes promovimit të përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimit artistik, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit

Prioriteti kryesor në këtë fushë është përmirësimi i cilësisë në institucionet e arsimit të lartë. Kjo ka shumë aspekte duke përfshirë përshtatjen e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, promovimin e kërkimit shkencor dhe lehtësimin e punës artistike si dhe inovacionit në institucionet e arsimit të lartë. Cilësia e mësimdhënies dhe nevoja për të rritur lëvizshmërinë akademike të stafit akademik dhe studentëve, si dhe pjesëmarrja në programet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, do të kenë vëmendje gjithashtu. Megjithëse ky prioritet është me sa duket i bazuar në nën-sektor, në realitet është i lidhur në një sërë mënyrash me pjesën më të madhe të pjesës tjetër të PSAK-ut 2017-2021: për shembull, pjesëmarrja e ndryshme e studentëve në arsimin e lartë mund të arrihet nëse nxënësit nga grupet e marginalizuara janë të përfshira në një masë të kënaqshme në arsimin parauniversitar (PS 1); trajnimi i mësimdhënësve të arsimit universitar, ndërsa detyra e institucioneve të specializuara të arsimit të lartë duhet të realizohet në përputhje me kërkesat e mësimdhënies cilësore (PS 4).

Shtojca 7: Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar e Republikës së Kosovës

1.3. Qëllimet e Arsimit Parauniversitar

Arsimi në Kosovë ka për qëllim zhvillimin e dijes, të shkathtësive, të qëndrimeve dhe të vlerave që i kërkon shoqëria demokratike. Kjo u mundëson të rinjve të jenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm, të përballin në mënyrë konstruktive dallimet dhe sfidat si dhe të respektojnë të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjerëve.

Të rinjve, arsimi në Kosovë do t'u krijojë kushte për zhvillim të pavarur, në mënyrë që të përmbushin jetën e tyre personale dhe të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien e shoqërisë kosovare.

Në këtë kontekst, qëllimet e arsimit janë:

- kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore
- promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare
- zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit
- aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore
- zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë
- aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

Arsimi do t'u mundësojë nxënësve që të kuptojnë, të respektojnë dhe të kultivojnë traditat kombëtare dhe të komunitetit ku jetojnë, të vlerësojnë traditat e familjes, të kultivojnë dhe të kontribuojnë në pasurimin e trashëgimisë së tyre kulturore, të rajonit ku jetojnë dhe më gjerë. Nxënësit do të aftësohen që të shfrytëzojnë në mënyrë kreative dijen dhe shkathtësitë e tyre në situata të ndryshme dhe kontekste të reja; të angazhohen në mënyrë individuale dhe në bashkëpunim me të tjerët në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve si dhe të ushtrojnë shkathtësitë për mendim të pavarur dhe kritik.

Nxënësit do të përkrahen që të zhvillojnë përgjegjësinë për veten, për të tjerët dhe për mjedisin, në kontekst të vetëdijesimit për pasojat e veprimeve personale, si dhe vetëdijesimit për rëndësinë dhe përgjegjësinë për ndërmarrjen e iniciativave.

Nxënësit do të përkrahen që të zhvillojnë vetëbesimin dhe motivimin pozitiv, si dhe të shfrytëzojnë të drejtat e tyre. Ata do të përkrahen që të kultivojnë kërkshërinë e tyre si dhe qëndrimin pozitiv ndaj së ndryshmes, në kuptim të ideve, fenomeneve, personave kulturave etj.

Arsimi do t'u mundësojë nxënësve të kontribuojnë me tërë potencialin e tyre në ndërtimin dhe mirëqenien e shoqërisë kosovare, duke zhvilluar njëkohësisht pavarësinë e tyre individuale dhe aftësinë për të ndërtuar jetën që a ta i përmbush personalisht.

Qëllimet e përgjithshme të arsimit janë të integruara në rezultatet e përcaktuara të të nxënësve, në përmbajtjet mësimore dhe duhet të jenë në kulturën e përditshme të shkollës.

Realizimi i tyre obligon të gjitha institucionet arsimore dhe aktorët e tjerë që janë pjesëmarrës në procesin edukativo-arsimor të Republikës së Kosovës.

Parimet e Kornizës së Kurrikulës

Korniza Kurrikulare ka një rol rregullues të tërë sistemit të arsimit parauniversitar dhe parimet e përbashkëta

sigurojnë koherencën dhe konsistencën e këtij sistemi. Prandaj, parimet kryesore për udhëheqjen e procesit të hartimit të Kornizës Kurrikulare do të jenë referenca kryesore edhe për hartimin e Kurrikulës Bërthamë (Kurrikula e përbashkët për të gjithë nxënësit) dhe për hartimin e të gjitha dokumenteve të tjera Kurrikulare.

GJITHËPËRFSHIRJA

Ky parim i referohet së drejtës së secilit fëmijë dhe të ri për përfshirje të barabartë në arsim cilësor. E udhëhequr nga ky parim, Korniza Kurrikulare mundëson zgjidhje të modifikueshme për t'i trajtuar dallimet e nxënësve në procesin e mësimnxënies dhe nevojat e tyre të veçanta, duke kontribuar kështu në zhvillimin e plotë të potencialeve mësimore të secilit. Duke i pasur parasysh nevojat individuale dhe stilet e të nxënësve, përvojat mësimore në shkollë do të nxisin motivimin për mësim, si kusht për përmirësimin e vijueshmërisë së shkollës dhe nivelit të arritjes së nxënësve.

Në këtë kontekst, Korniza e Kurrikulës promovon:

- të nxënësve që reflekton përvojat dhe informacionet paraprake të nxënësve, interesimet, potencialin dhe mundësitë e tyre,
- të nxënësve kuptimplotë (p.sh. i orientuar në zgjidhjet e problemeve praktike nga përditshmëria jetësore) dhe
- përfshirjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e përvojave të të nxënësve, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e përvojave të caktuara dhe në gjendje për të vlerësuar dhe për të vetëvlerësuar rezultatet vetjake të të nxënësve.

ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE

Korniza Kurrikulare përcakton qartë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, të cilat shoqëria dhe ekspertët arsimorë i konsiderojnë të domosdoshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në Kornizën Kurrikulare, kompetencat kryesore reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënësve, që pritet të arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë nxënësit me përfundimin e shkollës së mesme të lartë.

Në Kurrikulën Bërthamë, kompetencat kryesore do të reflektohen nëpërmjet një sistemi të të Rezultateve të të Nxënësve (RN), që duhen të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit. Përcaktimi i kompetencave kryesore, të shprehura nëpërmjet rezultateve të të nxënësve, që duhen të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit dhe përcaktimi i kriterëve për vlerësimin e nivelit të arritjes sigurojnë:

- mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit për të nxënë,
- vlerësim të drejtë të nivelit të arritjes së nxënësve,
- vlerësim të saktë të cilësisë së arsimit që ofrohet në nivel vendi, komune apo shkolle,
- kalim të nxënësve nga një nivel në tjetrin, nga një shkollë në tjetrën, apo nga një lloj shkolle në tjetrën.

Përcaktimi i rezultateve të pritura, që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit, njëkohësisht mundëson edhe akreditimin e programeve të ndryshme arsimore, që ofrohen në kuadër të Arsimit joformal. Me këtë njëkohësisht mundësohet edhe lëvizshmëria ndërmjet arsimit forma dhe joformal, nëpërmjet procesit të njohjes së dijes paraprake, me të cilën do të përfitojë dukshëm arsimimi i të rriturve dhe format e tjera të arsimit joformal.

MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E INTEGRUAR DHE KOHERENT

Korniza Kurrikulare promovon të nxënit e plotë, që reflekton ndërlidhjet dhe ndërvarësitë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu me dijen dhe informacionin që ne kemi për to.

Në këtë kontekst, Kurrikula përfshinë:

- (a) rekomandime të qarta mbi planifikimin e përvojave mësimore për të mbështetur nxënësit gjatë tërë sistemit të arsimit parauniversitar drejt zotërimit të kompetencave të përcaktuara dhe
- (b) kriteret e vlerësimit për të konstatuar saktësisht nivelin e arritjes së nxënësve në periudha të caktuara kohore.

Për të mundësuar një qasje të tillë, Korniza Kurrikulare parasheh:

- Promovimin e të nxënit të integruar nëpërmjet fushave të gjera kurrikulare, në kuadër të të cilave përmbajtja lëndore është e ndërlidhur me çështjet ndërkurrikulare dhe kontribuon në zhvillimin e kompetencave kryesore (për shembull, integrimi i shkencave natyrore dhe integrimi i shkencave shoqërore në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët);
- Përforcimin e ndërlidhjes ndërmjet fushave të ndryshme kurrikulare në funksion të një procesi të plotë dhe të shumanshëm mësimor, duke u mundësuar nxënësve konfirmimin e ndërlidhjes së të gjitha aspekteve të procesit mësimor, të të gjitha përvojave mësimore në kuadër të fushave të ndryshme kurrikulare.
- Ndërlidhjen kuptimplotë ndërmjet aspektit konceptual dhe dimensioneve praktike, si zbatimi i dijes dhe shfrytëzimi i shkathtësive, i qëndrimeve dhe i vlerave të caktuara në kontekst të zgjidhjes së problemeve praktike dhe reale të jetës së përditshme.
- Integrimin e fushave të reja kurrikulare, që reflektojnë zhvillimet në sferën shoqërore, ekonomike, kulturore apo të shkencës.
- Perspektivën e të nxënit gjatë gjithë jetës: Kurrikula do t'i përgatisë nxënësit që të ballafaqohen me sukses në jetën e tyre të përditshme me sfidat e vazhdueshme dhe mundësitë që ofron një shoqëri e dijes dhe të nxënit, duke u kushtuar vëmendje të veçantë kompetencave kreative, si: mësimi për të nxënë, kompetencave për vlerësimin dhe procedimin efektiv e të ndërgjegjshëm të informacionit, të nxënit elektronik dhe kompetencat për shfrytëzimin e teknologjive aktuale dhe të ardhshme të epokës digjitale (si: teknologjia e komunikimit dhe e informimit, të nxënit elektronik, jo si një lëndë e veçantë, por si mënyrë e të menduarit dhe e të vepruarit, vetëdijesimi për mediat, shkathtësitë proaktive jetësore).

AUTONOMIA DHE FLEKSIBILITET NË NIVEL SHKOLLE

Korniza Kurrikulare është përcaktuar për një sistemi i cili rregullon qartë normat e autonomisë dhe të fleksibilitetit të shkollës.

Autonomia dhe fleksibiliteti për zbatimin e Kurrikulës në nivel shkollë kanë të bëjnë me mundësinë dhe përgjegjësinë e shkollës për:

- Hartimin vjetor të planit mësimor dhe shfrytëzimin fleksibil të kohës shkollë, duke mundësuar forma të mësimdhënies interaktive; Kurrikula Bërthamë për shkollët e Kurrikulës do të përcaktojë përqindjen minimale të fondit të orëve për secilën fushë kurrikulare (periudha që përfshijnë dytri vite shkollë), përderisa planet mësimore për lëndët e veçanta gjatë një viti shkollor do të përpilohen në nivel shkollë.
- Planifikimin dhe shfrytëzimin e pjesës zgjedhore të Kurrikulës, përfshirë mundësinë për:

- (a) rritjen e fondit të orëve në kuadër të fushave përkatëse kurrikulare dhe
- (b) zhvillimin dhe zbatimin e elementeve plotësuese kurrikulare për të përmbushur nevojat e veçanta të nxënësve të saj si dhe për të reflektuar rrethanat në të cilat shkolla përkatëse vepron

PËRGJEGJËSIA DHE LLOGARIDHËNIA

Korniza Kurrikulare, krahas promovimit të autonomisë dhe fleksibilitetit në nivel shkolle, parasheh edhe vendosjen e një mekanizmi të qartë të llogaridhënies për tërë hierarkinë e sistemit të arsimit. Përgjegjësia dhe llogaridhënia i referohen para së gjithash procesit të zbatimit të Kornizës së Kurrikulës si dhe sistemit të arsimit në tërësinë e tij.

Gjatë procesit të zbatimit të Kurrikulës, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe krijimit të një kulture të vlerësimit të vazhdueshëm, që nënkupton idenë që ndjekja e progresit në zbatimin e kërkesave të Kurrikulës të bëhet pjesë normale e funksionimit të shkollave. Në suaza të këtij procesi, kuadri mësimor, kuadri drejtues i shkollave dhe autoritetet komunale të arsimit do të përfshihen në një proces të vazhdueshëm të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, dokumentimit të sfidave dhe zgjidhjeve drejt një paraqitjeje me të mirë në përmbushjen e kërkesave të Kurrikulës dhe ngritjes së cilësisë së arsimit.

Në këtë kontekst, zbatimi i Kurrikulës në nivel shkolle parasheh:

- Angazhim aktiv të shkollës në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të përvojave të mësimdhënies dhe të të nxënësve drejt ngritjes së nivelit të arritjeve të nxënësve;
- Angazhim të shkollave dhe komunave në një proces të vazhdueshëm të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, dokumentimit të sfidave dhe zgjidhjeve drejt përmbushjes së kërkesave të Kurrikulës;
- Zinxhir të qartë të mbështetjes, raportimit dhe llogaridhënies

Shtojca 8: Standardet për praktikën profesionale për drejtorët e shkollave në Kosovë

Standardi 1 (Udhëheqja dhe Motivimi):

Drejtori i shkollës promovon suksesin e shkollës dhe të nxënësve të tij duke lehtësuar zhvillimin, duke artikuluar dhe zbatuar një vizion të mësimit të reflektuar në vlerat, misionin, qëllimet dhe mësimdhënie në klasë që janë të përbashkët të shkollës..

NJOHURITË:

Drejtori i shkollës ka njohuri dhe të kuptuarit e:

- a) Kornizës së Kurrikulit të Kosovës;
- b) Krijimit të vizionit, misionit dhe synimeve;
- c) Zhvillimit dhe zbatimit të planeve strategjike dhe vjetore të shkollës; ç) Strategjive të angazhimit që nxisin bashkëpunimin;
- d) Zhvillimit organizativ;
- dh) Procesit të ndryshimit për sistemet, organizatat dhe individët;
- e) Mjeteve për planifikim (duke përfshirë edhe analizat SWWOT)
- ë) Praktikrat efektive të udhëheqjes;
- f) Komunikimit efektiv;
- g) Analizave dhe përdorimit të të dhënave në vendim-marrje duke respektuar të mësuarit e nxënësve;
- gj) Transparencës dhe llogaridhënies.

TREGUESIT E PERFORMANCËS:

Drejtori i shkollës kryen aktivitetet e mëposhtme për ta arritur standardin:

- a) Komunikon dhe udhëhiqet nga një filozofi arsimore e bazuar mbi kërkime të shëndosha, përvojën personale dhe reflektimin;
- b) përfshin komunitetin e shkollës (baraspeshë të drejtë gjinore dhe të pakicave etnike të mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe komunitetit) në zhvillimin e planit strategjik dhe planit vjetor të punës për shkollën, duke përfshirë vizionin, misionin dhe synimet e shkollës;
- c) Harton dhe administron procedurat operacionale në lidhje me planet e shkollës për të maksimizuar mundësitë për mësim të suksesshëm;
- ç) Përdor të dhënat relevante demografike që kanë të bëjnë për nxënësit dhe familjet e tyre në zhvillimin e misionit dhe synimeve të shkollës;
- d) Komunikon në mënyrë efektive vizionin dhe misionin stafit të shkollës, prindërve, nxënësve dhe anëtarëve të komunitetit;
- dh) Siguron që vizioni, misioni dhe zbatimi i planeve të monitorohen rregullisht, të vlerësohen dhe rishikohen sipas nevojës;
- e) Identifikon, sqaron dhe adreson barrierat, përfshirë edhe ato shoqërore, për arritjen e vizionit;
- ë) Siguron që planifikimi, vendim-marrja dhe strategjitë e zbatimit të jenë të bazuara në një vizion të përbashkët dhe në të kuptuarit e kulturës së shkollës;

- f)) Lehtëson ndryshimin dhe promovon inovacionin në përputhje me nevojat aktuale dhe të ardhme të komunitetit të shkollës;
- g) Analizon një gamë të gjerë të të dhënave (përfshirë kur është e përshtatshme, të dhënat e ndara sipas gjinisë) për të përcaktuar progresin drejt arritjes së qëllimeve të shkollës duke përfshirë të dhënat e vlerësimit që kanë të bëjnë me të mësuarit e nxënësve;
- gj) Komunikon dhe feston arritjet e shkollës për të frymëzuar zhvillim të vazhdueshëm;
- h) Raporton tek stafi, bordi i shkollës, komuniteti dhe komuna në lidhje me nivelet e përmbushjes së planeve strategjike dhe vjetore të shkollës.

Standardi 2 (Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies):

Drejtori i shkollës siguron që të gjithë nxënësit të kenë qasje të vazhdueshme në mundësitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies cilësore duke nxitur një kulturë të shkollës që vlerëson dhe mbështet të mësuarit e nxënësve, zhvillimin e stafit profesional sipas mundësive të barabarta.

NJOHURITË:

Drejtori i shkollës ka njohuri dhe të kuptuarit e:

- a) Rritjes dhe zhvillimit të nxënësve;
- b) Nxënësve me nevoja të veçanta dhe programeve të edukimit special;
- c) Të mësuarit e të rriturve;
- ç) Modeleve të zhvillimit të stafit profesional;
- d) Stilet e të mësuarit, menaxhimit të klasës dhe metodat e teknikat e mësimdhënies; dh) Motivimit për mësim;
- e) Zbatimit, përshtatjes, pasurimit dhe vlerësimit të kurrikulës; ë) Parimeve të mësimdhënies efektive;
- f)) Matjes dhe vlerësimit; Vlerësimit për nxënie dhe Vlerësimin nga të nxënit;
- g) Diversitetit dhe ndikimit të saj në programe arsimore;
- gj) Rolit të teknologjisë në promovimin e të mësuarit të nxënësve dhe aftësimin profesional të stafit;
- h) Motivimit për të mësuarit e të rriturve - stafit dhe prindërve.
- i) Barazisë gjinore dhe çështjeve të barazisë në arsim në Kosovë.

TREGUESIT E PERFORMANCËS:

Drejtori i shkollës kryen aktivitetet e mëposhtme për ta arritur standardin:

- a) Promovon dhe lehtëson zhvillimin kuptimplotë profesional për mësimdhënësit, prindërit dhe të tjerët, me fokus në të mësuarit e nxënësve në përputhje me vizionin dhe synimet e shkollës;
- b) Identifikon, sqaron dhe trajton sfidat për të mësuarit e nxënësve duke përfshirë edhe ato çështje bazuar në kontekstin gjinor;
- c) Siguron që nxënësit me nevoja të veçanta të marrin pjesë në programin e duhur;
- ç) Promovon dhe krijojnë model për të mësuarit gjatë gjithë jetës për nxënësit dhe stafin;
- d) Promovon një kulturë të pritjeve të larta për nxënësit dhe stafin;
- dh) Miraton dhe zbaton programet kurrikulare, bashkë-kurrikulare dhe ekstra-kurrikulare që janë në dispozicion të barabartë për të gjithë nxënësit;

- e) Zbaton strategjitë për shfrytëzimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë mbi të arriturat e nxënësve; ë) Siguron që praktikat e vlerësimit të nxënësve në të gjithë shkollën të jenë të drejta, të përshtatshme dhe të ekuilibruara;
- f)) Siguron që pedagogjia e përshtatshme është duke u shfrytëzuar në përgjigje të aspekteve të ndryshme të diversitetit të studentëve;
- g) Përdor burime të ndryshme të informatave në vendimet që ndikojnë në mirëqenien e nxënësve në shkollë;
- gj) E njeh potencialin e teknologjive të reja dhe në zhvillim, dhe bën të mundur integrimin e tyre kuptimplotë në mbështetje të mësimdhënies dhe të nxënësve.

Standardi 3 (Planifikimi dhe Menaxhimi):

Drejtori i shkollës menaxhon shkollën, aktivitetet shkollore dhe burimet për të siguruar përjetimin e një mjedisi të sigurt, të shëndetshëm dhe efektiv të të mësuarit.

NJOHURITË

Drejtori i shkollës ka njohuri dhe të kuptuarit e:

- a) Praktikave, parimeve dhe çështjeve të menaxhimit të lidhura me:
 - i. menaxhimin financiar të shkollës;
 - ii. kujdesin dhe përdorimin e objekteve shkollore;
 - iii. sigurinë dhe qetësinë e shkollës;
- b) Procedurave operacionale në nivel shkolle, komune dhe atë kombëtar;
- c) Menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore;
- ç) Teknologjive aktuale që mbështesin funksionet e menaxhimit.

TREGUESIT E PERFORMANCËS:

Drejtori i shkollës kryen aktivitetet e mëposhtme për ta arritur standardin:

- a) Në mënyrë efektive planifikon, organizon dhe menaxhon burimet njerëzore, fizike dhe financiare të shkollës dhe identifikon fushat e nevojës;
- b) Siguron që vizioni, misioni dhe synimet e shkollës të udhëzojnë vendimet e udhëheqjes dhe organizimin e mësimi;
- c) Menaxhon kohën për të arritur qëllimet organizative;
- ç) Identifikon problemet dhe mundësitë e mundshme;
- e) Siguron që objektet shkollore, pajisjet dhe sistemet e mbështetjes veprojnë në mënyrë të sigurt, efikase dhe efektive;
- d) Përdor në mënyrë efektive dhe efikase burimet financiare dhe mjetet për të mbështetur rezultatet e përmirësuar të të mësuarit të nxënësve;
- dh) Planifikon dhe drejton një sistem efektiv të planifikimit buxhetor të bazuar në planet strategjike dhe vjetore të shkollës në bashkëpunim me këshillin (bordin) e shkollës;
- e) Krijon dhe mban një mjedis të sigurt, të pastër dhe miqësor të shkollës;
- ë) Përdor teknologjinë në menaxhimin e shkollës.

Standardi 4 (Bashkëpunimi dhe ndërveprimi/bashkërendimi):

Drejtori i shkollës ndërton marrëdhënie të forta me komunitetin e shkollës (nxënës, mësues, prindër, bordi i shkollës dhe aktorë të tjerë) si dhe promovon udhëheqjen e përbashkët në përputhje me interesat e nxënësve të këtij komuniteti.

NJOHURITË

Drejtori i shkollës ka njohuri dhe të kuptuarit e:

- a) Ndikimit të prindërve në të mësuarit e nxënësve;
- b) Rolit dhe ndikimit të prindërve, bordit (këshillit) të shkollës dhe DKA-së në aktivitetet shkollore;
- c) Përdorimit të drejtë të burimeve të prindërve dhe komunitetit;
- ç) Të strategjive për marrëdhënie dhe komunikim me komunitetin
- d) Modeleve të suksesshme shkollës, familjes, biznesit, komunitetit, qeverisë dhe partneriteteve arsimore institucionale;
- dh) Aftësive të zgjidhjes së problemeve.

TREGUESIT E PERFORMANCËS:

Drejtori i shkollës kryen aktivitetet e mëposhtme për ta arritur standardin:

- a) Angazhon prindërit në mënyrë proaktive në mënyrë që t'i përfshijë ata në edukimin e fëmijëve të tyre dhe jetën e shkollës;
- b) Ndanë përgjegjësinë me stafin, nxënësit dhe komunitetin për të përforcuar angazhimin dhe llogaridhënien;
- c) Mbështet përdorimin e drejtë të burimeve të prindërve dhe komunitetit për të përparuar mësuesin dhe të nxënës;
- ç) Është i vetëdijshëm dhe i bën të tjerët të vetëdijshëm për zhvillimet e reja që kanë mundësi të ndikojnë në shkollë - komunitet;
- d) Siguron që të gjithë nxënësit dhe stafi të ndjehen të vlerësuar dhe të rëndësishëm;
- dh) Angazhon shkollën - komunitetin në identifikimin dhe adresimin e fushave për përmirësimin e shkollës;
- e) Siguron që mësuesin dhe personeli tjetër të komunikojnë dhe bashkëpunojnë me prindërit dhe anëtarët e komunitetit sipas rastit, në mbështetje të të mësuarit e nxënësve;
- ë) Ndërton marrëdhënie të respektit reciprok me anëtarët e bordit (këshillit) të shkollës dhe i pajis me informata të nevojshme për të përmbushur rolin e tyre;
- f) Merr vendime bazuar në nevojat dhe pritjet e komunitetit të shkollës;
- g) Tregon kujdesin për të tjerët dhe kultivon një klimë të respektit të ndërsjellë me të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës;
- gj) Krijon partneritete me bizneset lokale dhe institucionet arsimore për të përforcuar programet dhe mbështes synimet e shkollës;
- h) Komunikon në mënyrë adekuate me nxënësit, stafin, prindërit dhe komunitetin;
- i) Ndërton dhe mirëmban marrëdhënie të shëndosha me mediat dhe palët e interesuara;
- j) Promovon punë ekipore dhe udhëheqje të përbashkët mes anëtarëve të shkollës - komuniteti;
- k) Identifikon dhe mbikëqyrë mësuesin për rolet udhëheqëse në të ardhmen;
- l) Pranon përgjegjësi dhe kontributet e çdo individi; ll) Përdor aftësitë efektive të zgjidhjes së problemeve.

Standardi 5 (Legjislacioni dhe Shoqëria):

Drejtori i shkollës kupton dhe përgjigjet në mënyrë etike ndaj konteksteve politike, sociale, ekonomike, ligjore dhe kulturore që ndikojnë në shkollë.

NJOHURITË:

Drejtori i shkollës ka njohuri dhe të kuptuarit e:

- Ligjet dhe rregulloret arsimore (duke përfshirë ato që lidhen me femrat dhe gjininë) të Kosovës;
- Politikat përkatëse të komunave;
- Rolin e arsimit në zhvillimin e demokracisë;
- Proceset politike, sociale, kulturore dhe ekonomike që ndikojnë në shkollë;
- Arsyen për politikat kombëtare në arsim në lidhje me vlerat dhe aspiratat e komunitetit; dh) Proceset e ndërmjetësimit, konsultimit dhe zgjidhjes së problemeve;
- Zhvillimet globale që ndikojnë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;

TREGUESIT E PERFORMANCËS:

Drejtori i shkollës kryen aktivitetet e mëposhtme për ta arritur standardin:

- Përcjell zhvillime lokale, kombëtare dhe globale në lidhje me arsimin;
- Promovon komunikim të vazhdueshëm duke respektuar çfarëdo çështje me politikat kombëtare dhe komunale dhe aspiratat e komunitetit për shkollën, duke përfshirë ndryshimet në mjedisin ku vepron shkollë;
- Mban komunikim të vazhdueshëm me akterët e ndryshëm;
- Avokon për mbështetjen e komunitetit të shkollës dhe sistemit arsimor më gjer;
- Siguron që shkollë punon në kuadër të politikave, ligjeve dhe rregulloreve, të miratuara nga autoritetet lokale dhe shtetërore.

Standardi 6 (Etika profesionale):

Drejtori i shkollës vepron me integritet, korrektësi dhe etik të lartë.

NJOHURITË

Drejtori i shkollës ka njohuri dhe të kuptuarit e:

- Qëllimit të arsimit dhe rolit të udhëheqjes në shoqërinë moderne;
- Parimit dhe praktikën e përfshirjes në kuadër të shkollës dhe komunitetit të shkollës;
- Kornizave të ndryshme etike dhe këndvështrimet mbi etikën; ç) Vlerat e shkollës – komunitetit të shumëllojshëm;
- Kodet e etikës profesionale.

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Drejtori i shkollës kryen aktivitetet e mëposhtme për ta arritur standardin:

- a) Shqyrton vlerat personale dhe profesionale të tij/saj;
- b) Shërben si një model roli përmes:
 1. Pasqyrimin të kodit të etikës personale dhe profesionale;
 2. Reflektimit të vlerave, besimeve dhe qëndrimeve që frymëzojnë të tjerët që të rrisin nivelin e performancës;
 3. Pranimit të përgjegjësisë për funksionet e shkollës;
 4. Njohjes së praktikave të mira të të tjerëve;
 5. Trajtimin të të gjithë njerëzve në mënyrë të drejtë, të barabartë, dhe me dinjitet e respekt;
 6. Mundësimin të qasjes për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga vështirësitë fizike apo intelektuale, gjinisë, racës, fesë ose pozitës sociale;
 7. Ekzaminimit dhe marrjes parasysh të vlerave brenda komunitetit shkollor të shumëllojshëm;
- c) Shfrytëzon ndikimin e pozitës për të rritur cilësinë e arsimit e jo për përfitime personale;
- ç) Mbron të drejtat dhe fshehtësinë e nxënësve dhe stafit;
- d) Njeh dhe respekton autoritetin legjitim të të tjerëve;
- dh) Ndikon të tjerët në komunitetin e shkollës për të demonstruar integritetin dhe për të ushtruar sjelljen etike;
- e) Siguron që shkolla të jetë publikisht e përgjegjshme;
- ë) Kryen detyrimet ligjore dhe aplikon ligjet dhe procedurat në mënyrë të drejtë.
- f) Siguron një proces transparent dhe të barabartë për përzgjedhjen e nxënësve, mësimitdhënësve dhe të tjerëve si përfaqësues të shkollës në aktivitetet, ngjarjet ose për mundësitë e zhvillimit profesional.

Shtojca 9: Objektivat e Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë

Strategjia e Sigurimit të Cilësisë ka katër komponentë të ndryshëm, të paraqitur nëpërmjet objektivave strategjike në vijim.

Objektiva 1: Ndërtimi i mekanizmave efektiv për sigurimin e cilësisë

Në përgjithësi, sigurimi i cilësisë në Kosovë është një përgjegjësi e përbashkët e tri subjekteve të ndryshme: 1) Inspektoratit të Arsimit, i cili vepron në nivel qendror dhe përfaqëson interesin e qeverisë dhe të publikut të gjerë, 2) Drejtorive Komunale të Arsimit që drejtojnë shkollat dhe i japin përgjegjësi komuniteteve përkatëse, dhe 3) Shkollave si ofrues të drejtpërdrejt të shërbimeve.

Sigurimi i Cilësisë është përgjegjësi e përbashkët e Inspektoratit të Arsimit, Drejtorive Komunale të Arsimit dhe shkollave. DKA-të duhet t'i mbështesin shkollat në baza ditore, ndërsa roli i Inspektoratit të Arsimit është që të kryejë vlerësime periodike të jashtme, institucionale dhe të identifikojë fushat prioritare për përmirësim. Shkollat duhet të fuqizohen për të realizuar sistemet e tyre të brendshme të sigurimit të cilësisë, ku përgjegjësitë për menaxhimin e tyre duhet të ndahen midis stafit të shkollës.

Masat e planifikuara për përmirësim

Masa	Përshkrimi	Përgjegjës
<i>Masa 1.1.</i>	Ndërtimi i një sistemi efektiv për vlerësimin e shkollës (Inspektimi Administrativ, Inspektimi Pedagogjik)	MASH, Inspeksioni i Shkollës
<i>Masa 1.2.</i>	Zbatimi i Ciklit të Menaxhimit të Cilësisë në Arsim	MASH, Inspeksioni i Shkollës, DKA, Shkolla
<i>Masa 1.3.</i>	Fuqizimi i organeve të shkollave (departamentet dhe këshillat) për të kryer funksionin e tyre të sigurimit të cilësisë dhe për emërimin e një koordinatori të cilësisë.	Shkolla, DKA, MASH
<i>Masa 1.4.</i>	Definoni rolin e DKA-ve në sigurimin e cilësisë dhe krijoni strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë	MASH, DKA
<i>Masa 1.5.</i>	Siguroni funksionimin e Inspektoratit të Arsimit në aspektin ligjor-administrativ dhe pedagogjik-profesional	MASH
<i>Masa 1.6.</i>	Bëjeni funksional sistemin e licencimit të mësimitdhënësve	MASH, Inspeksioni i Shkollës
<i>Masa 1.7.</i>	Përdorimi efikas i të dhënave të monitorimit të arsimit për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet	MASH, Inspeksioni i Shkollës, DKA, Shkolla

Objektivi 2: Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel të shkollës dhe komunës

Planifikimi i zhvillimit të shkollës paraqet hapin fillestar në menaxhimin e punës në një mënyrë të orientuar drejt cilësisë. **Qëllimi parësor i planifikimit të zhvillimit të shkollës është më shumë përmirësimi i cilësisë sesa vlerësimi i të gjitha nevojave dhe raportimi i progresit.** Me kalimin e vazhdueshëm të përgjegjësive nga niveli qendror në komuna dhe komunat në shkolla, planifikimi i zhvillimit të shkollave është një detyrë në nivelin e secilës shkollë.

Hartimi i planit të zhvillimit të shkollës është zemra e procesit të zhvillimit të shkollës, pasi që përcakton objektivat pedagogjike të shkollës. Ky dokument strategjik zhvillohet në një proces pjesëmarrës, duke përfshirë stafin e shkollës, Këshillin Drejtues të Shkollës si dhe përfaqësuesit e komunitetit dhe bizneseve lokale, ku cikli i planifikimit mbështet krijimin e një “kulture të cilësisë” në shkollë.

Planifikimi i zhvillimit të arsimit duhet gjithashtu të zhvillohet në nivel komunal. Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit reflekton përparësitë komunale në fushën e arsimit, dhe nëse ekziston si i tillë, duhet të shërbejë si bazë për planifikimin e zhvillimit të shkollës. Nga ana tjetër, ai bazohet në prioritetet kombëtare të zhvillimit, dhe duhet të pasqyrojë nevojat e komuniteteve shkollore brenda komunës, kështu që një pjesëmarrje e gjerë dhe përfaqësim i drejtë i të gjitha grupeve të interesit është një domosdoshmëri.

Masat e planifikuara për përmirësim:

Masa	Përshkrimi	Përgjegjës
<i>Masa 2.1.</i>	Rishikimi i procedurave dhe instrumenteve për planifikimin e zhvillimit të cilësisë.	MASH, Inspeksioni i Shkollës, DKA
<i>Masa 2.2.</i>	Monitorimi dhe zbatimi i planeve zhvillimore të shkollave	DKA, Inspeksioni i Shkollës, MASH
<i>Masa 2.3.</i>	Harmonizimi i planeve komunale me planet e shkollave sipas fushave të cilësisë	DKA, MASH
<i>Masa 2.4.</i>	Promovimi i ndarjes së praktikave më të mira	Shkolla, DKA, MASH

Objektivi 3: Ndërtimi i kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet

Krijimi i një sistemi të plotë të sigurimit të cilësisë kërkon ndryshime në legjislacion dhe një ndarje të re të përgjegjësi ndërmjet nivelit qendror, lokal dhe shkollor. Kjo duhet të shoqërohet me masa të ngritjes së kapaciteteve, të cilat përfshijnë personelin dhe zhvillimin e stafit në Departamentin e Inspektoratit për Arsim, zyrat e DKA-ve, si dhe përpjekje të konsiderueshme për zhvillimin e kapaciteteve në nivel shkollë dhe të MASH-it.

Masat e planifikuara për përmirësim:

Masa	Përshkrimi	Përgjegjës
<i>Masa 3.1.</i>	Ndërtimi i kapaciteteve të inspektimit për përgjegjësi të reja	MASH, organizatat/ institucionet partnere, Inspeksioni i Shkollës
<i>Masa 3.2.</i>	Zhvillimi i doracakut për departamentet e shkollës me fokus të qartë në zhvillimin e cilësisë	MASH, Inspeksioni i Shkollës
<i>Masa 3.3.</i>	Trajnimi i stafit të DKA-ve, drejtorëve, dhe stafit përgjegjës të shkollave për menaxhim të cilësisë	MASH dhe organizatat/ institucionet partnere
<i>Masa 3.4.</i>	Sigurimi i ndihmës nga grupet profesionale në nivel komunal	DKA, MASH
<i>Masa 3.5.</i>	Trajnimi i përfaqësuesve të shkollave dhe komunave për planifikimin e zhvillimit	MASH organizatat/ institucionet partnere
<i>Masa 3.6.</i>	Prezantimi i sistemit të mentorimit për mësimdhënës të ri në shkolla	MASH dhe organizatat/ institucionet partnere

Objektivi 4: Ngritja e vetëdijes së akterëve për sigurimin e cilësisë

Ekziston nevoja për vetëdijesim për sigurimin e cilësisë së një shkolle të tërë si një institucion i bazuar në një kuptim të përbashkët të asaj se çka nënkuptohet me një shkollë të mirë dhe mësimdhënie/mësimnxënie të mirë. Staf i shkollës pra duhet të zotohet dhe angazhohet në proceset e zhvillimit institucional që kërkohen për të identifikuar përparësitë e zhvillimit dhe të reflektojnë rregullisht mbi arritjet e tyre, dhe duke u fokusuar në detyrën themelore të secilës shkolle, që është organizimi i proceseve të mësimdhënies/mësimnxënies cilësore në një mjedis mundësues dhe inkurajues për të gjithë nxënësit.

Gjithashtu, ndërgjegjësimi për nevojën për të siguruar cilësinë e arsimit duhet të rritet në mesin e nxënësve, prindërve dhe publikut të gjerë. Një qasje e tillë rrit përgjegjësinë dhe krijon presion mbi shkollat, autoritetet lokale dhe qendrore për të punuar fort në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të arsimit dhe sigurimin e rezultateve më të mira mësimore.

Masat e planifikuara për përmirësim:

Masa	Përshkrimi	Përgjegjës
<i>Masa 4.1.</i>	Publikimi i rezultateve të testeve kombëtare dhe ndërkombëtare	Shkolla, DKA, MASH
<i>Masa 4.2.</i>	Promovimi i tregimeve të suksesit dhe çmimeve të fituara	Shkolla, DKA, MASH
<i>Masa 4.3.</i>	Informimi i prindërve për aspekte të ndryshme të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë	Shkolla, DKA, MASH
<i>Masa 4.4.</i>	Promovimi i debateve publike mbi cilësinë e arsimit	MASH, DKA, Shkolla
<i>Masa 4.5.</i>	Krijimi i portalit të sigurimit të cilësisë	MASH, DKA, Shkolla

